

'08

RAPORT VJETOR



© 2009

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni AMF.

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa : Rruga "Perlat Rexhepi", Kati II, Tiranë

Tel : +355-4-2247148, 2250686

Faks : 355-4-2250686

E-mail : amf@amf.gov.al

URL : www.amf.gov.al



Fjala Përshëndetëse e Kryetares	6
PJESA I	
AMF, PREZANTIMI DHE AKTIVITETI	7
Kapitulli 1	
Organizimi i AMF	
1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore	7
1.2 Menaxhimi dhe organizimi	8
1.3 Buxheti dhe financimi	15
Kapitulli 2	
Aktiviteti i AMF	17
2.1 Aktiviteti rregullues	17
2.2 Aktiviteti licencues	22
2.3 Aktiviteti mbikëqyrës	30
2.4 Teknologjia e informacionit	41
2.5 Bashkëpunimi institucional	44
2.6 Marrëdhëniet me publikun, transparenca	47
Kapitulli 3	
Mbrojtja e Konsumatorit	50
PJESA II	
TREGJET E MBIKËQYRURA	52
II.1 Tregu i sigurimeve, zhvillimet, tendencat	52
II.2 Tregu i letrave me vlerë	59
II.3 Tregu i pensioneve private suplementare	62
SHTOJCA	65

Fjala Përshëndetëse e Kryetares



Elisabeta Gjoni, Kryetare e AMF

Zonja dhe Zotërinj,

Kam kënaqësinë t'ju vë në dispozicion raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) mbi veprimtarinë dhe aktivitetin e zhvilluar gjatë vitit 2008, në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri.

Viti 2008 ka qenë një vit intensiv dhe me zhvillime pozitive në drejtim të përmbushjes së objektivave dhe prioriteteve të AMF-së që nga krijimi i institucionit. Prioritetet e përcaktuara në drejtim të zhvillimit të mbikëqyrjes, rishikimit të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për tregjet financiare jo-bankare dhe përshtatjes së tij me direktivat Evropiane dhe standardet ndërkombëtare, si dhe zhvillimit të një sistemi të përshtatshëm të teknologjisë së informacionit me baza të dhënash të shumfishta, janë konkretizuar gjatë vitit 2008.

Viti 2008 u karakterizua nga zhvillime pozitive në tregun e sigurimeve, duke ruajtur në këtë mënyrë dinamikën e zhvillimeve dhe ngjarjeve të rëndësishme në këtë treg, ku mund të veçohet përfundimi me sukses i rritjes së nivelit minimal të fondit të garancisë në nivelet e përcaktuara në direktivat Evropiane. Angazhimi intensiv për hartimin e katër projektligjeve, për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, për sipërmarrjet e fondeve të investimeve, për fondet private të pensioneve dhe për obligacionet, ka qenë një hap tepër ambicioz, i cili jo vetëm synon përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullativ, por do të ndihmojë për t'i dhënë një impuls tjetër dhe frymëmarrje tregut financiar jo-bankar.

Qëndrueshmëria makroekonomike e Shqipërisë, progresi në regjimin rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit financiar jo-bankar, potencialet e larta që ofron vendi, masat e marra në drejtim të parandalimit të efekteve të krizës financiare botërore, pritet të shoqërohen me një zhvillim të mëtejshëm të tregjeve financiare jo-bankare.

Bashkëpunimi me të gjithë aktorët dhe institucionet në vend, bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe homologe në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe tërheqjes së praktikave më të mira, mbetet një nga instrumentet kyçe në kryerjen e funksioneve të institucionit, si një Autoritet rregullator i konsoliduar.

Gjatë vitit 2008, është punuar në vazhdimësi që konsumatori të jetë një individ i mirëinformuar, vetpërcaktues, si dhe të jetë në gjendje të orientohet drejt në treg, proces ky që kushtëzohet gjithashtu edhe nga një mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparente e tregjeve.

Rritja e efektivititetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo-bankare është shoqëruar me fushatë edukuese dhe nxitëse për publikun nëpërmjet një rubrike të veçantë në faqen zyrtare të AMF, gjë që synon në rritjen e ndërgjegjësimit, interesit dhe për rrjedhojë të kërkesës për produkte financiare. AMF do të vijojë të gjejë së bashku me tregjet, mundësi të reja të zhvillimit të shëndoshë të tyre. Planifikimi i drejtë, i kombinuar me një staf të kualifikuar, dhe bashkëpunimi në rritje me tregjet, mbeten mjete të fuqishme në funksion të realizimit të prioriteteve dhe objektivave të AMF-së. Konsolidimi i kapaciteteve institucionale mbetet një prioritet me peshë në funksion të përballimit të sfidave të institucionit.

I jam mirënjohëse të gjithë stafit që ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe jam e bindur që do të vazhdojnë të japin kontributin e tyre të vlefshëm në ngritjen dhe konsolidimin në vazhdimësi të besimit dhe transparencës së tregjeve financiare jo-bankare në Shqipëri. Gjithashtu, dëshiroj t'ju përcjell edhe kolegëve të mi të Bordit të AMF-së një falënderim të veçantë për angazhimin e tyre të plotë, që vazhdon të nxisë punën e institucionit tonë në të gjitha drejtimet.

Uroj që ky raport t'i shërbejë lexuesit dhe ai të gjejë në të informacionin e dëshiruar.

Elisabeta GJONI

Kryetare



Kapitulli 1

Organizimi i AMF

- *Mbrojmë konsumatorët*
- *Promovojmë tregjet*
- *Zbatojmë ligjin*

1.1 Misioni, objektivat, funksionet themelore

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) u krijua në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, si një ent rregullator i konsoliduar për të mbikëqyrur tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. AMF është institucion qëndror, i pavarur nga ekzekutivi dhe raporton në Kuvend mbi aktivitetin e ushtruar gjatë vitit paraardhës.

INSTITUCIONET nën juridiksion

- Shoqëritë e sigurimit të jetës dhe jo-jetës
- Shoqëritë e risigurimit
- Bursa e Tiranës dhe tregjet e letrave me vlerë
- Ndërmjetësit e sigurimeve
- Qendra e Regjistrimit të Aksioneve
- Fondet e pensionit
- Ndërmjetësit financiarë të letrave me vlerë
- Depozitar dhe regjistruer të letrave me vlerë
- Ofruesit e shërbimeve dhe profesionistë të fushës

Misioni

Misioni themelor i AMF-së është mbrojtja e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve, e lidhur ngushtë me sigurinë e operatorëve të mbikëqyrur, duke garantuar përmbushjen e dispozitave ligjore.

Objektivat

Në përmbushjen e funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare udhëhiqet nga këto objektiva:

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve
- Nxitja e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare jo-bankare
- Sigurimi i respektimit të ligjit

Funksionet themelore të AMF-së

Funksionet kryesore të veprimtarisë së AMF-së janë rregullimi dhe mbikëqyrja e:

- tregut të sigurimeve dhe veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin

nga këto veprimtari,

- tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen veprimtaritë e subjekteve të lidhura me investime në letra me vlerë e që veprojnë në këtë treg,
- tregut të pensioneve suplementare dhe të veprimtarisë së këtij tregu, ku përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare, të ofruara nga institutet private të pensioneve suplementare,
- veprimtarive të tjera financiare jo-bankare, sipas përcaktimeve të bëra nga ligjet e veçanta të fushës, që në vijim do të quhen “tregje financiare jo-bankare”.

Funksionet bazë rregullative-mbikëqyrëse të AMF-së, parashikohen kryesisht në nenet 2 dhe 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe pjesërisht në ligjet e sektorëve të mbikëqyrur (Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Ligji nr. 8080, datë 01.03.1996, “Për Letrat me Vlere”, Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995, “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”). Një sërë funksionesh rregullative, të përshkruara në ligjet e fushave, adresohen në mënyra të ndryshme për shkak të trashëgimisë së varësive të ndryshme të tre rregullatorëve të mëparshëm. Për këtë arsye, rishikimet në kuadrin ligjor për të përcaktuar qartë kompetencat në hartimin, propozimin e standardeve, apo akteve nënligjore, përbëjnë një proces në vijim për integrimin e plotë institucional të AMF-së.

1.2 Menaxhimi dhe organizimi

Bordi i AMF-së

Bordi i AMF-së është organi drejtues dhe vendimmarrës i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Bordi i AMF-së është organ kolegjal, që përbëhet nga 7 anëtarë, 3 prej të cilëve janë anëtarë ekzekutivë me kohë të plotë dhe kryejnë përkatësisht funksionet e kryetarit dhe dy nënkryetarëve.

Të gjithë anëtarët e Bordit mandatohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me afate të shkallëzuara, që përcaktohen nominalisht. Bordi i AMF-së, ka përbërjen e mëposhtme:

▪ Elisabeta GJONI	<i>Kryetare</i>	▪ Diana LAMANI	<i>Anëtare</i>
▪ Ermela GUXHOLLI	<i>Nënkryetare</i>	▪ Miranda RAMAJ	<i>Anëtare</i>
▪ Keler GJIKA	<i>Nënkryetar</i>	▪ Saimir SALLAKU	<i>Anëtar</i>



Gjatë vitit 2008, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka zhvilluar mbledhje çdo muaj, në të cilat janë marrë vendime të ndryshme në përmbushje të funksioneve rregullative, funksioneve mbikëqyrëse dhe atyre institucionale. Më konkretisht, gjatë vitit 2008, janë marrë vendime të ndryshme rregullative që lidhen me hartimin dhe miratimin akteve ligjore e nënligjore në fushën e sigurimeve, atë të titujve dhe të pensioneve private. Vendimet e lidhura me funksionet mbikëqyrëse, përshijnë masa korrektive dhe sanksione që kanë synuar eliminimin e shkeljeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Vendime me rëndësi në kuadër të rregullimit të mëtejshëm të tregut, kanë qenë dhe ato për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe vlerësuesve të dëmeve. Vendimet e Bordit kanë trajtuar edhe anën institucionale të AMF-së dhe kanë mbështetur iniciativa të ndryshme për zhvillimin dhe promovimin e tregjeve të mbikëqyrura.

Në 2008, Bordi ka propozuar për miratim 2 Vendime të Këshillit të Ministrave, tashmë në fuqi, ka miratuar 7 akte të reja nënligjore të fushave të ndryshme dhe ka amenduar 2 rregullore ekzistuese. Njëkohësisht, bazuar në punën e stafit, si dhe këshillimet e Bankës Botërore dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, Bordi ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e tregut, duke ushtruar me përgjegjësi kompetencat për mbikëqyrjen e kujdesshme të tij.

Kompetencat e Bordit të AMF-së

1. Harton rregullat për përshkrimin dhe qëllimin e punës së çdo departamenti dhe njësie.
2. Harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij.
3. Harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara në ligj.
4. Shpërndan udhëzues të shkruar për interpretimin dhe zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore.
5. Miraton formatin e licencave, që lëshohen për ushtrimin e veprimtarive të mbikëqyrura nga AMF.
6. Lëshon, refuzon, pezullon apo heq licencat për ushtrimin e veprimtarisë në tregun financiar jo-bankar.
7. Kufizon ose ndalon investimet e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, kur ato nuk janë në përputhje me raportet rregullatore apo kur rrezikojnë pozicionin financiar të shoqërisë.
8. Shqyrton kushtet e kontratës së sigurimit, para se ato të hidhen në treg nga operatorët.
9. Miraton pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit dhe të shoqërive të risigurimit.
10. Miraton dhe shpërndan standarde kontabël dhe formatet e njoftimit financiar, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.
11. Miraton listën e ekspertëve kontabël për shoqëritë që veprojnë në tregjet financiare jo-bankare. ▶



Elisabeta Gjoni
Kryetare



Ermela Guxholli
Nënkryetare



Keler Gjika
Nënkryetar



Diana Lamani
Anëtare



Miranda Ramaj
Anëtare



Saimir Sallaku
Anëtar

12. Sipas ligjit, merr vendim për fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikëqyrura dhe emëron likuidatorin.
13. Miraton politikën e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të AMF-së.
14. Merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit.
15. Diskuton periodikisht raportet për veprimtarinë e departamenteve kryesore të Autoritetit.
16. Miraton projektbuxhetin dhe raportin vjetor të AMF-së.
17. Miraton çdo vit raportin për industrinë, në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut financiar jo-bankar.
18. Miraton afatet për paraqitjen e çështjeve për shqyrtim.
19. Miraton manualët e inspektimit.
20. Përcakton politikat e mbikëqyrjes, të kontrollit të subjekteve të mbikëqyrura dhe të zhvillimit të tregut financiar jo-bankar.
21. Vendos për blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës.
22. Miraton rregulla për emërimin dhe shkarkimin e stafit.
23. Kompetenca të tjera, të parashikuara nga ligji i AMF apo nga ligjet e fushës.

Struktura organizative e AMF-së

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Bordit të AMF-së. Struktura dhe organika e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u miratua me vendim të Kuvendit nr. 98, datë 30. 04. 2007 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Gjatë vitit 2008, AMF vazhdoi të funksionojë sipas strukturës së miratuar, nëpërmjet së cilës sigurohet ndarja e qartë e funksioneve dhe rolit të njësive përbërëse. Gjatë periudhës raportuese, organika e AMF-së përbëhet nga 45 punonjës, bazuar në ndryshimin e ligjit për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008.


Autoriteti rishikoi, që në fillim të vitit 2008, ndryshimet strukturore nën sugjerimet e VKM nr. 901, datë 19.12.2007 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve, nëpunësve civilë, nëpunësve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura”, të komentuar nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike, të cilat më pas i kaluan për miratim Kuvendit të Shqipërisë, me anë të Projektvendimit “Për një ndryshim në Vendimin nr. 98, datë 30.04.2007, “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare””.

Pritet një reagim zyrtar nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me projektvendimin e paraqitur nga Autoriteti.


Organizimi i strukturës së AMF-së në departamente kryesore dhe disa drejtori, mundëson një hierarki të përshtatshme për stafin e Autoritetit, një ndarje të saktë të përgjegjësisë, si dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet njësive.




Struktura sipas njësive



Struktura sipas profesionit



Struktura e stafit teknik të AMF sipas grupmoshës




Politikat e Burimeve Njerëzore

AMF e konsideron të rëndësishëm zhvillimin e burimeve njerëzore, si një proces nëpërmjet të cilit rritet efektiviteti i punës dhe sigurohen marrëdhënie optimale punëdhënës-punëmarrës. Gjatë vitit 2008, bazuar në strategjinë e burimeve njerëzore në përputhje me standardet bashkëkohore, sektori i burimeve njerëzore përmirësoi sistemin e vlerësimit të arritjeve individuale të punonjësve në punë. Ky vlerësim ndikoi në gjykimin dhe vlerësimin më objektiv dhe transparent të rezultateve në punë duke ndihmuar stafin menaxherial të kuptojë më mirë ecurinë konkrete të punës për çdo njësi dhe punonjës e njëkohësisht të bëjë të mundur edhe krahasimin ndërmjet tyre.

Procesi i rekrutimit

Në procesin e rekrutimit, prioritet ka qenë rekrutimi i specialistëve të kualifikuar, i studentëve të sapo diplomuar e me rezultate të larta në universitetet e vendit, si dhe ato jashtë vendit, nëpërmjet procedurave formale që lejojnë një përzgjedhje cilësore. Në funksion të kësaj politike, janë shfrytëzuar takime të kryera në nivel kombëtar, ku veçohen ato me forumin studentor "ALBSTUDENT" në bashkëpunim me USAID, në përmbushje të nismës "brain-gain", si dhe praktikat pranë institucionit apo prurjet konkrete nga njoftimet në shtypin e shkruar.

Struktura e stafit teknik sipas diplomimit



Në këtë proces, AMF mban gjithmonë parasysh parimin e ndërthurjes së eksperiencës së brezave dhe harmonizimin e përvojave të ndryshme.

AMF do të vazhdojë të synojë ndjekjen e politikave të përparura duke bashkëpunuar me institucione prestigjioze e me eksperiencë, apo me projekte që mundësojnë thellimin e mëtejshëm në politikat e burimeve njerëzore duke pasur parasysh zgjerimin e tregut financiar jo-bankar.



Kualifikimi profesional

AMF, edhe gjatë vitit 2008, ka vazhduar të konsiderojë prioritet të politikave të burimeve njerëzore, kualifikimin profesional të stafit sipas profileve dhe pozicioneve përkatëse. Kjo është sintetizuar në gamën e aktiviteteve të realizuara, brenda dhe jashtë vendit, në trajnime, seminare, konferenca, vizita në shkëmbimin e eksperiencave më të mira në fushën e rregullatorëve.

Shifrat tregojnë se në vitin 2008, rreth 77% e stafit teknik të AMF-së ka marrë pjesë aktive në seminare e trajnime të lidhura me fushat respektive që ata mbulojnë. Krahasuar me vitin 2007 ka pasur rritje në masën 13% të stafit të trajnuar.

Janë organizuar trajnime afatshkurtra brenda dhe jashtë vendit, mbështetur në ekspertizën dhe asistencën e institucioneve ndërkombëtare si: Banka Botërore, Këshilli i Evropës, FSVC, GTZ, si dhe shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve: IAIS, IOSCO, IOPS dhe NAIC.

Në mbështetje të politikave për thellimin e kualifikimit profesional të stafit, AMF gjatë vitit 2008 ka realizuar mbështetje financiare për disa nga punonjësit e saj duke financuar çertifikimin e tyre profesional dhe kualifikimet brenda dhe jashtë vendit. Kjo procedurë është kryer në përputhje me kontratat reciproke për shfrytëzimin e vlerave profesionale të përfutuara në funksion të aktivitetit të AMF-së.

Trajnim mbi Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar në fushën e sigurimeve

AMF, në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit në Maltë, organizoi trajnimin mbi standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (IFRS) në fushën e sigurimeve.

Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit në Maltë, njihet si institucion me një eksperiencë 30-vjeçare në industrinë e sigurimeve dhe me reputacion në të gjithë botën, në edukimin dhe trajnimet e menaxhimit të riskut të shërbimeve financiare e të sigurimeve. Gjatë vitit 2008 njohja me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, rëndësia dhe mënyra e adoptimit për herë të parë në pasqyrat financiare të shoqërive të sigurimit ka pasur një vëmendje të veçantë.



Seminar mbi sigurimet e jetës organizuar nga AMF, në bashkëpunim me Bankën Botërore, prill 2008

Auditi i brendshëm

Funksioni

Njësia e Auditit të Brendshëm kryen funksionin e saj në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Aktiviteti

Njësia e Auditimit të Brendshëm të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2008, ka realizuar programin e miratuar nga Bordi, i cili përfshinte përfundimin e 10 auditimeve. Aktiviteti i Auditit të Brendshëm kryhet nga një specialist i auditit. Çdo procedurë auditimi është realizuar mesatarisht në 25 ditë pune.

Pranë Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare janë raportuar periodikisht rezultatet e auditimeve. Nga Njësia e Auditimit, gjatë vitit 2008, janë dhënë 32 rekomandime, të cilat janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Arkiv - Protokoli

Funksioni dhe aktiviteti

Zyra e Arkiv-Protokollit kryen funksionin e saj në zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”. Pranë kësaj zyre depozitohet e gjithë korrespondenca zyrtare që hyn në AMF dhe regjistrohet gjithë korrespondenca që del jashtë AMF-së.

Viti 2008 është karakterizuar nga një fluks i lartë i praktikave të ardhura e të trajtuara në AMF, si tregues i rritjes së komunikimit të institucionit kryesisht me tregun dhe palët e interesit. Më konkretisht, gjatë vitit 2008, AMF ka dërguar 2500 shkresa zyrtare, nga të cilat 1300 janë përgjigje të praktikave drejtuar AMF nga palët e interesit. Pjesa tjetër i përket kryesisht praktikave të nisura nga AMF në institucionet e tjera nga ku AMF kërkon informacion ose sqarime për një praktikë të caktuar.

Vlen të theksohet, se rritja e komunikimit zyrtar me subjektet e mbikëqyrura përkon me fundin e periudhave tremujore, apo të analizave financiare që Autoriteti kryen në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së subjekteve të licencuara. Veçanti e këtij viti ka qenë edhe licencimi i vlerësuesve të dëmeve në sigurime, i cili ka ndikuar gjithashtu në rritjen e komunikimit zyrtar me aplikantët e ndryshëm, në zbatim të VKM nr. 164, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime”.

Siç përcaktohet edhe në detyrat e vendit të punës, pjesë e veprimtarisë së kësaj zyre është



edhe protokollimi i komunikimit të brendshëm. Pavarësisht rritjes së komunikimit të brendshëm elektronik, gjatë vitit 2008, strukturat e brendshme të AMF kanë protokolluar rreth 800 memo, raporte dhe relacione të ndryshme.

1.3 Buxheti dhe financimi

Në mbështetje të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", neni 26, AMF është institucion i pavarur, që kryesisht financohet nga burimet e veta. Buxheti i shtetit financon AMF-në në rast se shpenzimet për funksionimin normal nuk mund të përballohen nga fondet e veta, me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë. Tepricat e buxhetit të AMF-së për vitin financiar derdhen në buxhetin e shtetit brenda 4 muajve pas mbylljes së vitit financiar, me përjashtim të fondeve të destinuar për investimet që janë në proces.

Tabelë 1: Të ardhura të realizuara

<i>Burimi i Fondeve të AMF-së gjatë 2008</i>	<i>000 / Lekë</i>
1. Të ardhura të realizuara gjatë vitit 2008	113,204
2. Të ardhura nga financimi buxhetor	19,668
2.1 Për shpenzime funksionimi	12,996
2.2 Për investime	6,672
3. Të ardhura të trashëguara për investime në proces	29,200
TOTALI	162,072

Tabelë 2: Përdorimi i Fondeve të AMF-së

<i>Përdorim i Fondeve të AMF-së gjatë 2008</i>	<i>000 / Lekë</i>
1. Fonde për shpenzime funksionimi	96,544
2. Fonde për investim	44,396
2.1. Për investime të kryera	8,737
2.2. Për investime në proces	35,659
3. Për t'u derdhur në buxhetin e shtetit pas mbylljes së rezultatit ushtrimor	21,132
TOTALI	162,072

AMF përgatit pasqyrat financiare dhe mban kontabilitetin në përputhje me VKM nr. 248, datë 10.04.1989 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale dhe njësisve që varen prej tyre” si dhe Udhëzimit nr. 26, datë 27.12.2007 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore”.

Në zbatim të neneve 26 dhe 27 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, në të ardhurat e realizuara nga Autoriteti për vitin 2008, janë përfshirë: të ardhurat nga tregu i sigurimeve, letrave me vlerë, pensione, si dhe 20% e gjobave të arkëtuara nga shoqëritë e sigurimeve. Arkëtimi i këtyre gjobave mbështetet në Ligjin nr. 9267, datë 27.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, neni 172, pika 2 dhe 3. Pjesa tjetër e gjobave të arkëtuara ose 80% e tyre, derdhet nga Autoriteti në buxhetin e shtetit.

Nga fondet e alokuara nga buxheti i shtetit u përdorën rreth 13 milion Lekë për shpenzime funksionimi, dhe 6.67 milion Lekë për investime.

Pjesa e destinuar për investime në vlerën 29,200,000 lekë, që përbëhet nga fondet e vetë institucionit dhe me destinacion “Për rikonstruksionin e godinës”, mbartet për vitin pasardhës, si investim në proces.

Punimet për rikonstruksionin e godinës nuk kanë nisur pasi ndërtesa ende nuk është vënë në dispozicion, megjithëse i është alokuar AMF-së që në vitin 2007. Lëvizja në ambjentet e reja është e rëndësishme pasi ambjentet aktuale nuk ofrojnë hapësirat e mjaftueshme dhe të sigurta, të nevojshme për funksionimin e platformave online TI që menaxhon AMF, si dhe ndikojnë jo për mirë në cilësinë e punës së stafit.

Në strukturën buxhetit të AMF-së gjatë vitit 2008, shpenzimet e funksionimit të institucionit përbëjnë 60%, fondet për investimet e kryera dhe ato në proces përbëjnë 28%, ndërsa pjesa e fondeve për t'u derdhur në buxhetin e shtetit përbën 12%.

Kapitulli 2 Aktiviteti i AMF



2.1 Aktiviteti rregullues

Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor, që rregullon sektorët e mbikëqyrur, përfaqësojnë me direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian, si dhe përshtatja e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve, mbeten faktorët kryesorë në ndërmarrjen e nismave ligjore, të cilat kanë qenë prioritet i punës së AMF edhe për vitin 2008.

Ndryshimet Ligjore

Në fushën e sigurimeve

Në fushën e sigurimeve, kuadri nënligjor është më i konsoliduar se sa në sektorët e tjerë, megjithatë, zhvillimet e reja, si ai i licencimit të vlerësuesve të dëmeve në sigurime, nëpërmjet VKM përkatëse, ka sjellë detyrimin për hartimin e **Rregullores nr. 18, datë 27.03.2008 “Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime”**, e cila përcakton kushtet dhe rregullat e përgjithshme të organizimit të testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime.

Ndër ndryshimet të tjera të rëndësishme në kuadrin ligjor, në tregun e sigurimeve, mund të përmendet edhe **Udhëzimi nr. 15, datë 22.02.2008 “Për përmbajtjen e raporteve të auditimit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e eksperteve kontabël të autorizuar”**. Qëllimi i këtij udhëzimi ishte përcaktimi i elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti i auditimit mbi shoqëritë e sigurimit, hartuar nga shoqëritë e eksperteve kontabël të autorizuar. Ky udhëzim, synon të sjellë një përmirësim cilësor të standardeve të raportimit, nëpërmjet miratimit të rregullores për përmbajtjen e raporteve të auditimit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e eksperteve kontabël të autorizuar.

Në fushën e letrave me vlerë

I gjithë kuadri nënligjor në fushën e letrave me vlerë, ka qenë në proces plotësimi dhe përmirësimi gjatë këtij viti. Duke qenë se, kemi pasur një ligj të ri në këtë fushë, ka pasur nevojë për hartimin e akteve të reja nënligjore dhe ndryshimin në përmirësimin e atyre ekzistuese. Rregullorja më e rëndësishme për tregun është **Rregullorja nr. 120, datë 02.10.2008 “Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve”**. Rregullorja është mbështetur në direktivën MiFID dhe është konsultuar me ekspertë të huaj. Rregullorja, përveç rregullimit të procesit të licencimit, përmirëson nga ana rregullative shumë aspekte të tjera të organizimit të saj, si përbërja aksionare, format dhe rregullat e tregtimit e listimit dhe raportimin në Autoritet. Me miratimin e kësaj rregulloreje krijohet infrastruktura e duhur për një veprimtari bashkëkohore të Bursës.

Në këtë kuadër, janë miratuar edhe rregulloret e tjera të tregut të letrave me vlerë si:

Rregullore nr. 115, datë 11.09.2008 “Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e ruajtjes së librit të porosive dhe të librit të transaksioneve”. Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive dhe të transaksioneve, të cilët duhen të mbahen nga shoqëritë komisionere për sa u përket transaksioneve në lidhje me titujt, referuar në Nenin 42, pikat 1, 2, dhe 3 të Ligjit nr. 9876, datë 21.2.2008 “Për Titujt”.

Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008 “Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/ Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve”. Kjo rregullore përcakton dokumentacionin shoqërues të kërkesës dhe kriteret për licencim për veprimtari të tregtimit të titujve dhe të këshillimit në investime, përmbajtjen dhe procedurën e trajtimit të kërkesës për licencim, procedurën e miratimit të statutit të një shoqërie që krijohet për të ushtruar veprimtari të tregtimit dhe këshillimit në tituj, si dhe ndryshimet në këto akte dhe dokumentacionin për dhënien e miratimit të anëtarëve të bordit drejtues dhe drejtuesit kryesor të shoqërisë së brokerimit e këshillimit në investime.

Në fushën e pensioneve private

Rregullore nr. 11, datë 22.02.2008 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e instituteve private të pensioneve suplementare” që ka si qëllim mbikëqyrjen e instituteve private të pensioneve nga ana e Autoritetit, duke garantuar dhe siguruar që këto institute të ushtrjnë aktivitetin e tyre të sigurt dhe të qëndrueshëm, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore si dhe objektin e veprimtarisë së tyre.

Të tjera

Rregullore nr. 61, datë 22.05.2008 “Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve” që ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve, duke zhvilluar në këtë mënyrë një funksion të rëndësishëm të Autoritetit, atë të mbrojtjes konsumatore dhe duke sjellë përmirësim në shërbimin ndaj konsumatorit.

Udhëzim nr. 62, datë 22.05.2008 “Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësit” që ka si qëllim vlerësimin e punës dhe performancës së secilit anëtar të stafit në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Janë amenduar disa rregullore të brendshme, gjë që ka përmirësuar funksionimin e strukturave të Autoritetit si: **Rregullore nr. 3, datë 3.10.2007 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm”**, ndryshime të miratuara me vendim Bordi nr. 10 datë 03.01.2008, ku janë bërë ndryshime në nenin 4 të rregullores, që ka të bëjë me raportimin dhe identifikimin e policave dhe **Rregullore nr. 7, datë 30.08.2007 “Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**



Projekte ligjore

Zbatimi i angazhimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, do të vazhdojë të mbetet prioritet në të tre fushat: të sigurimeve, letrave me vlerë dhe të pensioneve private suplementare.

Për vitin 2008, kuadri ligjor dhe rregullativ i tregut financiar jo-bankar ka pësuar ndryshime progresive, në përgjigje të kërkesave dhe zhvillimeve të tregut dhe si reflektim i nevojës për një rregullim më të mirë dhe mbikëqyrje nga ana e Autoritetit.

Angazhimi intensiv për hartimin e katër projektligjeve, për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, për sipërmarrjet e fondeve të investimeve, për fondet private të pensioneve vullnetare dhe për obligacionet, është një hap tepër ambicioz, i cili do të ndihmojë për t'i dhënë një impuls tjetër dhe frymëmarje tregut financiar jo-bankar. Këto projekte janë realizuar gjatë vitit 2008 dhe pritet të dërgohen për miratim në Kuvendin e Shqipërisë, brenda vitit 2009.

Projektet kanë një shkallë të lartë të përafrimit me direktivat e BE, në fushat përkatëse. Projektligji i **sigurimit të detyrueshëm** është mbështetur në Direktivën 72/166/EEC “Për sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjeteve motorrike dhe zbatimin e detyrimeve që sigurojnë një përgjegjësi të tillë”, Direktivën 84/5/ECC “Për përafrimin e legjislacionit lidhur me sigurimin e përgjegjësisë civile që rezulton nga përdorimi i mjetit motorrik”, amenduar me direktivat 88/357/EEC, 90/232/EEC, Direktivën 2000/26/EC dhe Direktivën 2005/14/EC. Projektligji, pasi është miratuar si draft në Këshillin e Ministrave, më 12 shkurt 2009 u miratua në seancë plenare nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në fokus të projektit është përcaktimi i qartë i rregullave në mbrojtje të palëve të treta të dëmtuara nga aksidentet dhe të gjithë konsumatorëve të policave të sigurimit të detyrueshëm. Në funksion të këtij qëllimi, projekti sjell disa risi:

- Përmirëson procedurat e trajtimit të dëmeve, duke përfshirë dhe trajtuar për herë të parë konceptin e dëmit jo pasuror ose i ashtuquajtur “dëmi moral” që vjen si pasojë e vdekjeve dhe dëmtimeve shëndetësore të pësuar nga palët në një aksident, dhe në aspekte të tjera të trajtimit të dëmeve.
- Krijon detyrime për mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave të aksidenteve, duke hedhur bazat për krijimin e një sistemi bonus malus në të ardhmen, nëpërmjet krijimit të Qendrës së Informacionit në Sigurime.
- Zgjeron gamën e produkteve të sigurimit të detyrueshëm me dy produkte të reja:
 - (1) sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, si dhe
 - (2) sigurimin e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese.

Projektligji **“Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”** është mbështetur në Direktivën

85/611/EEC “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm” e amenduar nga Direktivat 88/220/EEC dhe 95/26/EC, Rregullore e Këshillit Evropian (S.I. nr. 211 të vitit 2003) “Shoqëritë për investimet kolektive në titujt e transferueshëm”. Projektligji mbush një boshllëk në kuadrin rregullativ të skemave kolektive të investimit në letra me vlerë. Projekti është kurorëzim i përpjekjeve disa vjeçare për të pasur një projekt të kompletuar, në përputhje me direktivat e Komisionit Evropian dhe të krahasueshëm nga pikëpamja e standardeve me modele të vendeve të tjera, anëtare të BE-së. Qëllimi i projektit është rregullimi i të gjitha formave të skemave të investimeve kolektive dhe veprimtarisë së tyre, mbrojtja e investitorëve nëpërmjet vendosjes së kërkesave për licencimin e skemave të investimit, shoqërisë administruese, kërkesave për autorizimin e depozitarit, kufizimeve në politikën e investimit, etj. Për gjithë projektin në tërësi, mund të themi se është ndjekur një frymë e kujdesshme, duke pasur parasysh zhvillimet aktuale ndërkombëtare në lidhje me krizën e tregjeve financiare të kohëve të fundit.

Projektligji **“Mbi fondet e pensionit vullnetar”** ka synuar të përafrohet dhe në disa pjesë të tij të jetë në përputhje me direktivat/rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe me udhëzimet e OECD – IOPS për licencimin e fondeve vullnetare të pensionit. Më konkretisht, projektligji është mbështetur në Direktivën 85/611/EEC “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me shoqëritë e investimeve kolektive për titujt e transferueshëm”, Direktivën 2003/41/EC “Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale” dhe Direktivën 2004/39/EC “Mbi tregjet e instrumentave financiarë, e cila amendon Direktivën 85/611/EEC, 93/6/EEC dhe Direktivën 2000/12/EC dhe shfuqizon Direktivën 93/22/EEC.

Projektligji mbi fondet e pensioneve vullnetare, propozohet, me qëllim përmirësimin e bazës ligjore për kolonën e tretë të pensioneve. Kuadri ligjor në fushën e pensioneve private paraqitet shumë i varfër, aktualisht Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, i cili është në fuqi, nuk i përshtatet standardeve ndërkombëtare dhe direktivave të BE.

Projektligji i ri **“Për obligacionet e shoqërive aksionere dhe të qeverisë vendore”** ka synuar të përafrohet me Direktivën 2004/109/EC “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë në lidhje me informacionin rreth lëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t’u tregtuar në tregjet e rregullta” që amendon Direktivën 2001/34/EC, Direktivën 2003/71/EC “Mbi publikimin e prospektusit kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për tu tregtuar” që amendon Direktivën 2001/34/EC. Draftimi i projektligjit ka si qëllim përmirësimin e bazës ligjore, zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe mbrojtjen e investitorëve. Ky projektligj po hartohet edhe në kuadër të ndryshimeve që pësoi legjislativi shqiptar në lidhje me ligjin publik financiar dhe tregtar, veçanërisht në lidhje me ligjet e reja të aprovuara “Ligji për Titujt” dhe “Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me qëllim që të arrihet përfshirja e projektligjit aktual në mënyrë harmonike me ligjet në fjalë. Në përgjithësi, vlen të përmendim se prezenca e një tregu të obligacioneve aktiv dhe eficient



në Shqipëri, u ofron emetuesve një mënyrë alternative për të rritur kapitalin e huasë.

Objektivat

Gjatë këtij viti janë strukturuar shumë prej akteve ligjore dhe nënligjore që duheshin hartuar, por ka edhe iniciativa të tjera që mbeten për t'u realizuar në vitin e ardhshëm. Së pari është ligji bazë i sigurimit dhe risigurimit, për të cilin janë evidentuar problemet dhe ndryshimet ligjore që kërkohen. Këto ndryshime janë duke u përgatitur në bashkëpunim me Bankën Botërore në kuadër të projektit për një mbikqyrje efektive, financuar nga FIRST Initiative. Me realizimin e këtij objekti përmbyllet matrica e akteve ligjore apo ndryshimeve ligjore të planifikuara. Tjetër objektiv është ndjekja e procesit të miratimit të projektligjeve, si dhe hartimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore në zbatim të këtyre projekteve të miratuara. Më afër në kohë, parashikohet të jenë një sërë rregullash që rrjedhin nga Ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit", duke qenë se ky është projekti i parë që është miratuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Akte ligjore të miratuara nga AMF gjatë vitit 2008

Në fushën e sigurimeve

1. Rregullore nr. 18, datë 27.03.2008 "Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime", e cila përcakton kushtet dhe rregullat e përgjithshme të organizimit të testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime.
2. Udhëzimi nr. 15, datë 22.02.2008 "Për përmbajtjen e raporteve të auditimit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e eksperteve kontabël të autorizuar", i cili përcakton elementet e domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti i auditimit mbi shoqëritë të sigurimit, hartuar nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Në fushën e letrave me vlerë

3. Rregullore nr. 120, datë 02.10.2008 "Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve", e cila rregullon procesin e licencimit dhe përmirëson nga ana rregullative shumë aspekte të tjera të organizimit të bursës.
4. Rregullore nr. 115, datë 11.09.2008 "Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e ruajtjes të librit të porosive dhe të librit të transaksioneve" e cila përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive, të cilat duhen të mbahen nga shoqëritë komisionere për sa u përket transaksioneve në lidhje me titujt.
5. Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008 "Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve" e cila përcakton dokumentacionin shoqëruar të kërkesës dhe kriteret për licencim për veprimtari të tregtimit të titujve dhe të këshillimit në investime, përmbajtjen dhe procedurën e trajtimit të kërkesës për licencim, procedurën e miratimit të statutit të një shoqërie që krijohet për të ushtruar veprimtari të tregtimit dhe këshillimit në tituj, si dhe ndryshimet në këto akte dhe dokumentacionin për dhënien e miratimit të anëtarëve të bordit drejtues dhe drejtuesit kryesor të shoqërisë së brokerimit e këshillimit në investime.

Në fushën e pensioneve private

6. Rregullore nr. 11, datë 22.02.2008 “Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e instituteve private të pensioneve suplementare” që ka si qëllim mbikëqyrjen e instituteve private të pensioneve nga ana e Autoritetit.

Të tjera

7. Rregullore nr. 61, datë 22.05.2008 “Për procedurat e trajtimit të ankesave të të siguruarve”, e cila përcakton kushtet dhe rregullat e përgjithshme për trajtimin e ankesave të të siguruarve.
8. Udhëzim nr. 62, datë 22.05.2008 “Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësit” që ka si qëllim vlerësimin e punës dhe performancës së secilit anëtar të stafit në AMF
9. Ndryshime në Rregulloren nr.3, datë 3.10.2007 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm” të miratuara me vendim Bordi nr. 10, datë 03.01.2008.
10. Ndryshime në Rregulloren nr.7, datë 30.08.2007 “Për rregullat e brendshme të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

2.2 Aktiviteti licencues

Në hartimin dhe zbatimin e politikave licencuese, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është udhëhequr nga parimi i drejtësisë, ndershmërisë dhe barazisë, duke synuar një treg financiar të drejtë dhe të rregulluar, si dhe rritjen e besimit të publikut ndaj këtij tregu.

Në politikat e tij licencuese, Autoriteti ka qenë gjithmonë transparent, duke synuar vendosjen e standardeve të njëjta për të gjitha tregjet nën mbikëqyrje.

Hartimi dhe publikimi i udhëzuesve në lidhje me praktikat e licencimit, ka qenë një nga mënyrat për t'i ardhur në ndihmë operatorëve të interesuar të tregut financiar jo-bankar.

Respektimi i kërkesave “fit and proper”, për personat që ushtrojnë funksione drejtuese dhe për aksionerët në subjektet nën juridiksion të Autoritetit ka qenë e mbetet një objektivi rëndësishëm për një treg të mirëregulluar.

Aktiviteti licencues në tregun e sigurimeve

Miratimi nga Këshilli i Ministrave i VKM nr. 164, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për licencimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime” dhe VKM nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës” i hapi rrugën rregullimit të profesionit të vlerësuesit të



dëmeve në sigurime, brokerit dhe agjentit në sigurime.

Vlerësuesit e licencuar të dëmeve në sigurime

Gjatë vitit 2008, u licencuan 32 vlerësuesit e parë, proces i cili shënoi vënien nën mbikëqyrje të profesionit të vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Në përputhje me dispozitat e VKM nr. 164, Autoriteti, mbështetur në kërkesën, arsimimin, kualifikimet, si dhe rezultatet e testit profesional të aplikuesit, përcakton në licencën e vlerësuesit të dëmeve në sigurime, fushën e veprimtarisë. Licenca mund të jetë:



Gjatë zhvillimit të testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime

- a) Për vlerësim të dëmeve materiale (motorrike dhe të pronës)
- b) Për vlerësim të dëmeve shëndetësore

Licencat e dhëna në 2008, konsistojnë në vlerësimin e dëmeve materiale dhe shëndetësore për klasat e jo-jetës. Gjithashtu, vlerësuesi i dëmeve në sigurime mund ta ushtrojë profesionin e tij ose i pavarur nga shoqëritë e sigurimit, ose si i punësuar pranë një shoqërie sigurimi.

Me fillimin e procedurave për licencimin e vlerësuesve, AMF, në tetor 2008, njoftoi të gjitha shoqëritë e sigurimit, se pas datës 1 janar 2009, vlerësimi i dëmeve në sigurime do të bëhet vetëm me vlerësues të licencuar. Ky vendim iu bë i njohur gjykatave të vendit, me qëllim përfshirjen e vlerësuesve të licencuar në proceset gjyqësore ku ata nevojiten.

Në respektim të kërkesave të VKM nr. 164, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi testin profesional për të gjithë aplikantët për pajisje me licencë të vlerësuesit të dëmeve në sigurime. Për t'i shërbyer sa më mirë procesit të licencimit të vlerësuesit dhe në ndihmë të të interesuarve, testimi u organizua rregullisht çdo muaj.

Të dhënat tregojnë se nga 65 aplikime për licencë vlerësuesi dëmsh në sigurime, vetëm 55 prej tyre kanë plotësuar kushtet për të hyrë në testim dhe nga këto 52 e kanë kaluar me sukses atë. Ndërkohë, iu është dhënë mundësia e ripërsëritjes së testimit pesonave të cilët nuk e kanë kaluar atë më parë.

Tabelë 3: Të dhëna mbi vlerësuesit e licencuar

Numri i vlerësuesve të licencuar 2008	Statusi i vlerësuesit		Lloji i licencës		
	i pavarur	i punësuar	për dëme materiale	për dëme shëndetësore	të dyja së bashku
32	11	21	1	6	25

Broker në sigurime

Viti 2008 shënoi një ndryshim në arkitekturën e tregut shqiptar të sigurimeve. Për herë të parë u licencua shoqëria e parë e brokerimit "MAI" sh.a dhe 2 brokerë fizikë që ushtrojnë veprimtarinë në emër të kësaj shoqërie brokerimi. Shoqëria "MAI" sh.a e licencuar në 11 shtator 2008, për aktivitet brokerimi në sigurime dhe risigurime, zotërohet 100% nga shoqëria "MAI CEE" si pjesë e "MAI Insurance Group", me eksperiencë shumëvjeçare në tregun e sigurimeve, një nga shoqëritë e madha të brokerimit në Evropën Lindore dhe Qendrore me 18 zyra në disa vende. Licencimi i shoqërisë "MAI" sh.a u shoqërua me licencimin e 2 brokerave fizikë në sigurime, pas plotësimit të të gjithë kërkesave ligjore të VKM nr. 79 dhe pas kalimit me sukses të testit profesional të organizuar nga AMF.

Gjatë vitit 2008, pati shprehje të interesit nga subjekte brenda dhe jashtë vendit për këtë veprimtari.

Agjentë në sigurime

Gjatë vitit 2008 vazhdoi procesi i licencimit të agjentëve në sigurime, kryesisht për shoqëritë e sigurimit; "Insig" sh.a, "Sigal UNIQA Group Austria" dhe "Sigal-Life Uniqa Group Austria". Viti 2008 shënoi përmirësimin e kërkesave të licencimit të agjentëve, në përputhje me VKM nr. 79 datë 28.01.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës".

Gjatë vitit 2008, Autoriteti miratoi licenca të reja për:

- 4 agjentë në sigurime për jo-jetë, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Insig" sh.a.
- Shoqërinë "Ak-Invest" sh.a dhe "Green Market" sh.p.k, si agjent në sigurime të jo jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit "Sigal-Life Uniqa Group Austria" sh.a dhe 2 përfaqësuesve të tyre.
- Shoqërinë "WVP-Ndërmjetësim në sigurime" sh.p.k. si agjent në sigurime të jetës në emër dhe për llogari të shoqërisë "Sigal-Life Uniqa Group Austria" sh.a, dhe 5 përfaqësuesve të saj.

Gjatë kësaj periudhe, Autoriteti tërhoqi 5 licenca për agjentë në sigurime në emër dhe për llogari të shoqërive të sigurimit, me kërkesë të të licencuarve.

Gjatë vitit 2008, përveç sa u përmend më sipër, disa shoqëri sigurimi kanë paraqitur kërkesën në AMF për licencimin e agjentëve të tyre, por për shkak të mangësive në

Tabelë 4: Agjente të licencuar, gjithsej

<i>Shoqëritë e sigurimit</i>	<i>Numri i shoqërive dhe agjentëve të licencuar</i>
INSIG sh.a	2 shoqëri 39 agjentë
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA	5 shoqëri 70 agjentë
SIGAL-LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA	1 shoqëri 5 agjentë



dokumentacion dhe mospërshtatshmërisë me kërkesat ligjore për dhënien e licencës, këto kërkesa nuk janë trajtuar duke njoftuar përkatësisht shoqëritë për plotësimin e tyre.

Plotësimi i fondit të garancisë për shoqëritë e sigurimeve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i kushtoi kujdes respektimit të afatit ligjor për plotësimin e transhit të tretë të fondit të garancisë nga shoqëritë e sigurimit, ku në përputhje me Ligjin nr. 9685, datë 26.02.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”” ky afat ishte deri në 31 mars 2008. Njëkohësisht, Autoriteti mori në analizë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi burimin e kapitalit në plotësim të fondit të garancisë, duke vlerësuar bashkëpunimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave për burimin e kapitalit. Të gjitha shoqëritë plotësuan fondin e garancisë në përputhje me kërkesat ligjore.

Rritja e prezencës së kapitalit të huaj dhe shtrirja e shoqërive shqiptare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë


Prezenca e kapitalit të huaj në tregun shqiptar të sigurimeve, që nga viti 2007, dëshmoi se ky treg është me potenciale të mëdha zhvillimi dhe tërheqës për investitorët e huaj. Viti 2008 shënoi një tjetër ngjarje të rëndësishme, për sa i takon hyrjes së investimeve të huaja në tregun e sigurimeve.

Gjatë vitit 2008, shoqëritë e huaja aksionere e rritën edhe më tej pjesëmarrjen influencuese në shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar të sigurimeve.

Në janar 2008 u miratua pjesëmarrja influencuese e shoqërisë “UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs” GmbH në shoqërinë “Sigal Holding” sh.a (zotëruese e kapitalit të shoqërisë “Sigal” dhe “Sigal-Life”) në masën 45.62%.

Në tetor 2008, rritet pjesëmarrja e shoqërisë “TBIH Financial Services Group N.V Amsterdam”, (ku “Vienna Insurance Group” zotëron 60% të kapitalit) në shoqërinë e sigurimit “Sigma” sh.a nga 75% +1 në 87% +1.

Struktura e kapitalit sipas vendit të origjinës - 2008



Nga ana tjetër edhe shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun shqiptar kanë rritur prezencën e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Kështu, krahas shoqërive të sigurimit si: “Insig” sh.a, “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a dhe “Sigma” sh.a me shtrirje në Kosovë dhe Maqedoni, shoqëria “Albsig” sh.a krijoi filialin e saj në Republikën e Maqedonisë. Në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” në 2008, AMF dha miratimin, duke respektuar edhe procedurat e miratimit të rritjes së kapitalit për shtrirjen e aktivitetit. Shoqëria e sigurimit “Sigma” sh.a në respekt të rregullave të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës për rritjen e fondit të garancisë, rriti kapitalin aksioner nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja në funksion të detyrimit për degën e Kosovës, me miratimin e AMF në prill 2008.

Ndryshime statutores të shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2008, Autoriteti miratoi 2 statute të reja, si dhe disa ndryshime të ndodhura në statutin e shoqërive të sigurimit, si rezultat i ngjarjeve që lidhen kryesisht me ndryshimin e kapitalit themeltar të shoqërive apo strukturën aksionare. Ndryshimet e miratuara nga AMF në lidhje me statutin e shoqërive të sigurimit janë të përmbledhura si më poshtë:

<i>Arsyeja e Ndryshimit të Statutit</i>	<i>Numri i Shoqërive</i>
Statut i ri	2
Rritje kapitali	9
Ndryshim i strukturës aksionare	2
Ndryshim i përbërjes së këshillit mbikëqyrës	2
Ndryshim i emërimit të shoqërisë	2

Elementë të rinj mbi procedurat e licencimit

Bordi i AMF miratoi në mars 2008, si pjesë e procesit të licencimit, formatin e licencës dhe të formular-kërkesës të aplikuesit për ndërmjetës në sigurime dhe vlerësuesi dëmeve në sigurime, si më poshtë:

- Formular-kërkesë për pajisje me licencë agjenti në sigurime.
- Formular-kërkesë për pajisje me licencë brokeri në sigurime.
- Formular-kërkesë për pajisje me licencë vlerësuesi dëmsh në sigurime.
- Formatin e licencës së brokerit si person fizik.
- Formatin e licencës së brokerit si person juridik.
- Formatin e licencës së vlerësuesit të dëmeve në sigurime si person fizik.
- Formatin e licencës së vlerësuesit të dëmeve në sigurime si person juridik.
- Formatin e licencës së agjentit në sigurime si person juridik.
- Deklarata mbi detyrimet e papaguara në afat për agjentin në sigurime.

Gjithashtu, gjatë vitit 2008, të gjithë të interesuarit për t'u pajisur me licencë ndërmjetësi në sigurime dhe vlerësues dëmsh në sigurime patën mundësi t'i drejtohen faqes zyrtare të AMF për t'u konsultuar me procedurat e licencimit dhe sqarime në lidhje me këto procedura.



Aktiviteti licencues në tregun e letrave me vlerë

Hyrja në fuqi e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i cili shfuqizoi Ligjin nr. 8080 datë 03.05.1996 “Për letrat me vlerë” parashtroi nevojën e shqyrtimit të licencave për shoqëritë e licencuara më parë nga Autoriteti për të ushtruar veprimtari në tituj (letrat me vlerë), ku sipas kërkesave të ligjit, këto shoqëri duhet të riorganizonin veprimtarinë e tyre, në përputhje me dispozitat e ligjit të ri brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Në tetor 2008, Autoriteti miratoi rregullat e veprimtarisë së shoqërisë “Bursa e Tiranës” sh.a, të riformuluara në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Bursa e Tiranës është krijuar dhe licencuar që në vitin 1996, si shoqëri aksionare shtetërore me pronar të vetëm Ministrinë e Financave. Në respekt të kërkesave të Ligjit të ri “Për titujt”, Autoriteti duke vlerësuar nivelin e zhvillimit të tregut të letrave me vlerë në Shqipëri, gjykoi vlefshmërinë e licencave të operatorëve ekzistues të tregut të letrave me vlerë, ku ndërkohë përcaktoi afate kohore për plotësimin e detyrimeve për mbajtje licence të disa prej tyre.

Në mars 2008, Bordi i AMF miratoi dhënien e licencës për shoqërinë “Banka Ndërkombëtare Tregtare” sh.a, si tregtar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH në Bursë për një periudhë pa afat dhe licencimin e përfaqësuesit tregtar të kësaj shoqërie për një periudhë një vjeçare.

Në shkurt 2008, interesit të paraqitur nga shoqëria “Alam Finwest” sh.a për veprimtari tregtari në tregun e letrave me vlerë, Autoriteti iu përgjigj nëpërmjet dhënies së pëlqimit për statutin dhe organet drejtuese të kësaj shoqërie, si hap i parë drejt fillimit të procedurave për licencim.

Në janar 2008, Bordi i Autoritetit miratoi kërkesën e shoqërisë “Banka Credins” sh.a për zgjerimin e objektit të licencës, me përcaktimin: Licencë “Për ushtrimin e veprimtarisë si regjistruar i letrave me vlerë të Qeverisë”.

Miratime të tjera në tregun e letrave me vlerë

- Ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Bursa e Tiranës” sh.a (gusht 2008)
- Ndryshim në statutin e shoqërisë “Kapital-Invest” sh.a në lidhje me strukturën aksionere (gusht 2008)
- Ndryshim në statutin e shoqërisë “Kapital-Invest” sh.a në lidhje me selinë dhe përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës (gusht 2008)
- Ndryshim në statutin e shoqërisë “Kapital-Invest” sh.a në lidhje me zmadhimin e kapitalit dhe strukturën aksionere (dhjetor 2008)

Aktiviteti licencues në tregun e pensioneve private

Edhe gjatë vitit 2008, veprimtaria e administrimit të pensioneve private suplementare u kufizua tek 3 shoqëritë e licencuara më parë si institute private të pensioneve suplementare. Mangësitë e kuadrit ligjor ekzistues në drejtim të kërkesave të licencimit, të standardeve

fit & proper në qeverisje, të politikave të investimeve dhe elementëve të mbikëqyrjes kanë diktuar e shprehur, kjo dhe në marrveshjen e shtetit Shqiptar me FMN, mbajtjen pezull të kryerjes së procedurave të lidhura me licencime të reja. Ndërkohë, AMF ka monitoruar e administruar me kujdes lëvizjen në shoqëritë ekzistuese, me qëllim ruajtjen e interesave të aderuesve. Në funksion të këtij objekti, Autoriteti miratoi disa ndryshime në lidhje me drejtuesit kryesore dhe anëtarët e këshillave mbikëqyrëse me synim përmirësimin e nivelit të menaxhimit të instituteve private të pensione.

Kështu:

- Në mars 2008, miratohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë “Capital IPP” sh.a.
- Në qershor 2008, miratohen anëtarët e rinj të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Sigma IPP” sh.a.
- Në shtator 2008, miratohet Bordi i ri i Drejtorëve të shoqërisë “Sigma IPP” sh.a.
- Në dhjetor 2008, miratohet Këshilli i ri Mbikëqyrës i shoqërisë “Capital IPP” sh.a.

Gjatë vitit 2008, Autoriteti monitoroi me kujdes dhe miratoi edhe disa ndryshime në strukturën aksionare të instituteve private të pensione, pas vlerësimit të cilësisë së aksionarëve të rinj.

Në dhjetor 2008, u miratua transferimi i pronësisë të aksioneve në masën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë “Instituti amerikan i pensioneve suplementare të Shqipërisë” sh.a tek aksionari i ri shoqëria “Banka Raiffeisen”, duke vlerësuar cilësitë menaxheriale dhe eksperiencën e gjatë në fushën financiare të kësaj shoqërie, me synim për të ofruar me shumë besueshmëri dhe qëndrueshmëri në tregun shqiptar të pensione vullnetare.

Në shtator 2008, u miratuan ndryshime në strukturën aksionare edhe në shoqërinë “Capital IPP” sh.a.

Struktura aktuale



Në qershor 2008, miratohet ndryshimi i emrit të shoqërisë “Garantsig IPP” sh.a në “Sigma IPP” sh.a duke pasqyruar ndryshimin e aksionarit me pjesëmarrje më të lartë, shoqërinë e sigurimit “Sigma” sh.a.


Qeverisja e shoqërive aksionare

Kuadri rregullativ mbi qeverisjen e shoqërive aksionare, sipas parimeve të OECD, duhet të promovojë tregje transparente dhe efçente, të jetë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe të ndajë qartë përgjegjësitë midis aksionerëve, administratorëve dhe autoriteteve të ndryshme rregullatore e mbikëqyrëse.

Në rritjen e rolit mbi qeverisjen e shoqërive të sigurimit, AMF ka respektuar kriteret për të zgjedhurit në këshillat mbikëqyrës, në



Numri i aksionarëve sipas pjesëmarrjes zotëruese



postet drejtuese apo komitetet e kontrollit. Në të njëjtën kohë, AMF ka tentuar të nxisë rritjen e integritetit, profesionalizmit, eksperiencës dhe kualifikimit, brenda kufizimeve dhe mungesave të theksuara të ligjeve ekzistuese.

Gjatë vitit 2008, janë realizuar tre miratime për drejtorë të përgjithshëm të shoqërive të sigurimit dhe janë miratuar ndryshime për anëtarët e këshillave mbikëqyrës në katër shoqëri sigurimi.

Qeverisja e shoqërive të sigurimit – statistika	2007	2008
▪ Numri mesatar i aksionarëve	6	4.5
▪ Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës	5	3.6
▪ Numri mesatar i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që nuk janë aksionarë	2	2.8
▪ Numri i Drejtorëve Ekzekutivë me pjesëmarrje influencuese mbi 10%	3	3

Tabelë 5: Të dhëna për aksionarët

Emërtimi	Numri
Shoqëri sigurimi	10
Aksionarë gjithsej	45
Me pjesëmarrje zotëruese si më poshtë:	
nën 10%	22
mbi 10% nën 20%	10
mbi 20% nën 33 %	4
mbi 33% nën 50%	2
mbi 50%	7
Aksionarë të huaj	5
Aksionarë vendas	40
Aksionarë si individë	37
Aksionarë si shoqëri	7
Aksionarë shteti	1

2.3 Aktiviteti mbikëqyrës

Viti 2008 u karakterizua kryesisht nga zhvillime pozitive dhe një qëndrueshmëri e tregut të sigurimeve në përgjithësi. Brenda një periudhe dymbëdhjetëmuajore shoqëritë e sigurimit duhet të dispononin kapital minimal në formën e fondit të garancisë në nivelet e vendeve të BE-së. Fondi i Garancisë, si për shoqëritë e sigurimit të Jetës dhe ato të Jo-Jetës tashmë është minimalisht në masën 370 mln lekë. I gjithë procesi i rritjes së kapitalit në të gjitha format e përzgjedhura nga shoqëritë e sigurimit është ndjekur me përparësi nga AMF dhe është mbyllur me sukses, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mbikëqyrja efektive e sigurimeve

Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, me asistencën e Bankës Botërore dhe financim të FIRST Initiative, në vitin 2008, filloi projekti “Për Mbikëqyrjen Efektive”, i cili ka për qëllim përfundimin e metodologjisë së mbikëqyrjes, duke kaluar në një përjasje me bazë rrisht. Projekti ka si objekt mbikëqyrjen efektive të sigurimeve, rishikimin e bazës ligjore dhe përbëhet nga dy pjesë:

- (1) Mbikëqyrja efektive nëpërmjet zhvillimit të një mbikëqyrje me bazë rrisht.
- (2) Rishikimi i legjislacionit në fushën e sigurimeve.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë:

- Promovimi i një tregu eficient sigurimesh, të sigurt dhe të qëndrueshëm, me qëllim mbrojtjen e policmbajtësve.
- Dizenjimi i një metodologjie efektive të mbikëqyrjes me bazë rrisht dhe të një platforme mbikëqyrjeje efikase.
- Rritja e kapaciteteve të AMF, për të vlerësuar rrishtet e pjesëmarrësve të tregut, përdorimi eficient i burimeve dhe vendosja e prioriteteve të ndërhyrjes.
- Forcimi i kuadrit rregullativ dhe i mbikëqyrjes së sigurimeve.
- Rritja e kapaciteteve rregullative dhe institucionale të AMF.
- Rishikimi i bazës ligjore për tregun e sigurimeve.

Pjesë e këtij procesi është edhe hartimi i manualeve të inspektimit dhe analizës financiare. Manualët mbulojnë një gamë të mjaftueshme çështjesh, si dhe përfshijnë një numër modelesh që do të ndihmojnë stafin mbikëqyrës në marrjen e vendimeve gjatë procesit të vlerësimit të rrishtit dhe analizës financiare të shoqërive të sigurimit.

Manuali i inspektimit, fillimisht, vlerëson zonat e ndryshme të rrishtit të biznesit sikurse janë:

- Risku i kreditit
- Risku i likuiditetit
- Risku i pamjaftueshmërisë së provigjoneve teknike
- Risku nga palët e lidhura
- Risku tregut
- Risku i marrjes në sigurim
- Risku operacional

Niveli i rrishtit në secilën kategori biznesi mund të vlerësohet i ulët, i moderuar ose i lartë

- **Risht i ulët biznesi:** Ekspozimi i siguruesit në zonën e rrishtit të biznesit konsiderohet më i ulët se mesatarja
- **Risht i moderuar biznesi:** Ekspozimi i siguruesit në zonën e rrishtit të biznesit konsiderohet të jetë mesatar
- **Risht i lartë biznesi:** Ekspozimi i siguruesit në zonën e rrishtit të biznesit konsiderohet të jetë më i lartë se mesatarja

AMF e kryen funksionin e saj të mbikëqyrjes së tregjeve përmes analizimit të dokumentave (kontrolli dokumentar “off site”) të raportuara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe ndërmarrjes së inspektimeve në vend tek subjektet e mbikëqyrura (inspektimi në vend “on site”).



Inspektimi dokumentar (off site) kryesisht bazohet në analizimin e pasqyrave periodike, teknike e financiare, të depozituara nga subjektet e mbikëqyrura, si dhe çfarëdo dokumentacioni të kërkuar me ligj. Nëse nga analizimi i pasqyrave vihen re parregullsi apo mangësi, AMF reagon përkatësisht për eliminimin e tyre.

Inspektimi në vend (on site) mund të jetë i planifikuar apo ad hoc, por mund të jetë i lidhur dhe me sinjalet e ndryshme apo ankesat, në lidhje me aktivitetin e subjekteve të mbikëqyrura. Kontrolli në vend dhe ai dokumentar mund të përfshijnë një tematikë të gjerë, ose mund të fokusohen në çështje të veçanta.

Objektivat kryesore të inspektimit on site

1. Njeh siguruesin dhe ambientin e biznesit të tij d.m.th vlerëson risqet e tij
2. Evidenton zonat me risk të lartë
3. Evidenton problemet që lidhen me aftësinë paguese
4. Evidenton mospërputhjen me legjislacionin
5. Merr informacion për çështje të sistemit të shpërndarjes
6. Zgjidh problemet në kohë të parakohshme

Analiza Financiare e Tregut të Sigurimeve (off site)

Autoriteti ka monitoruar gjendjen financiare të shoqërive të sigurimit mbështetur në bazën ligjore në fuqi. Procesi është përqendruar si në monitorimin e procesit të raportimit të saktë dhe në kohë të pasqyrave financiare, ashtu edhe në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit gjatë vitit 2008.

Autoriteti, në kuadër të krizës financiare globale, ka ndjekur një strategji të kujdesshme për të monitoruar, parandaluar dhe reaguar ndaj efekteve negative të krizës financiare në tregun financiar shqiptar të mbikëqyrur prej tij. Në përputhje me këtë strategji, u ndërmorën hapat e mëposhtëm:

- i) analiza e situatës aktuale, duke evidentuar risqet me ekspozim më të lartë ndaj efekteve të krizës ndërkombëtare, duke konsideruar skenarët e mundshëm, si dhe reagimin përkatës.
- ii) realizimi i takimeve me shoqëritë e sigurimit për të diskutuar për situatën dhe orientuar drejt masave për mbrojtjen ndaj risqeve me ekspozim më të madh.
- iii) kërkimi i raportimeve më të shpeshta, të detajuara nga tregu dhe institucione të tjera shtetërore, në lidhje me të dhënat financiare, portofolin e investimeve dhe risqet madhore, etj.
- iv) kryerja e takimeve në kuadër të Grupit të Stabilitetit Financiar, pjesëmarrës të të cilit janë AMF, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë, për të marrë në konsideratë situatën dhe koordinimin e aktiviteteve.

Struktura e tregut të sigurimeve, edhe gjatë vitit 2008, vazhdon të përbehet nga dhjetë shoqëri sigurimesh, nga të cilat shtatë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e jo-jetës, dy në sigurimet e jetës dhe një në sigurimet e jo-jetës dhe jetës së bashku.

AMF ka ndjekur në vazhdimësi përmbushjen e kërkesës ligjore mbi fondin e garancisë të shoqërive të sigurimit dhe zbatimin e rregullave për investimin e tij. Aktualisht shoqëritë e sigurimit zotërojnë fondin e garancisë të investuar në “depozita qëllimore” me afat të paktën 1-vjeçar, pranë bankave të nivelit të dytë dhe bono thesari, sipas kërkesave të ligjit. Gjatë vitit 2008 është ndërjerë ndikimi pozitiv që ka sjellë hyrjen e investitorëve të huaj në tregun e sigurimeve, në krijimin e hapësirave të nevojshme për konkurrencë dhe zhvillim në treg.

Në tregun shqiptar të sigurimeve marrin pjesë shoqëritë “Aspis Holdings Public Company Ltd” me qendër në Oipro, me 51% të aksioneve të shoqërisë së sigurimit “Interalbanian” sh.a, “TBIH Financial Services Group N.V” me qendër në Amsterdam, Holandë me 75% + 1 të aksioneve të shoqërisë së sigurimit “Sigma”sh.a dhe shoqëria “UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH”, Austri me 45.62% të Sigal Holding.

Tabelë 6: Disa Karakteristika mbi Tregun e Sigurimeve

Vlera (në mln Lekë)

<i>Periudha Ushtrimore</i>	<i>2004</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>
Totali i aktiveve	8,411	10,216	11,453	13,360	15,525
Jeta	840	1,140	1,171	1,401	1,841
Jo-Jeta	7,571	9,076	10,282	11,959	13,684
Totali i investimeve	5,923	6,946	8,014	9,255	11,182
Jeta	706	898	973	1,071	1,389
Jo-Jeta	5,217	6,049	7,041	8,184	9,793
Provizjonet teknike bruto	4,211	4,917	5,518	5,929	5,138
Jeta	88	131	218	227	233
Jo-Jeta	4,124	4,786	5,300	5,702	4,905
Totali i kapitalit	3,685	4,689	5,557	6,956	8,832
Jeta	629	942	926	1,247	1,541
Jo-Jeta	3,056	3,747	4,632	5,709	7,291
Totali i kapitalit të nënshkruar	2,783	3,396	3,788	5,191	6,031
Jeta	628	868	868	1,001	1,248
Jo-Jeta	2,155	2,528	2,920	4,190	4,783
Totali i investimeve të huaja	893	1,068	1,149	2,378	2,924
Jeta	200	224	215	379	460
Jo-Jeta	693	844	933	1,999	2,463
Primet e shkruara bruto	4,151	4,011	4,542	5,948	7,076
Jeta	114	239	302	410	515
Jo-Jeta	4,037	3,772	4,239	5,538	6,561
Primi i fituar neto	3,814	3,730	3,910	4,705	5,543
Jeta	86	201	241	357	459
Jo-Jeta	3,728	3,529	3,669	4,348	5,083
Dëmet e paguara bruto	1,037	1,226	1,287	1,294	1,571
Jeta	7	15	12	44	45
Jo-Jeta	1,030	1,211	1,275	1,250	1,526



Gjatë analizës së gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, për vitin 2008, vihen re këto tendenca:

Totali i aktiveve të tregut të sigurimit arriti në vlerën 15.5 mld lekë, nga 13.3 mld lekë që ishte në 31.12.2007, duke shënuar një rritje në masën 16%. Vihet re një dinamikë e lartë rritje kryesisht në investime në depozita, në pasuri të paluajtshme, si dhe në zërat, Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara e të Patrupëzuara.

Depozitat me afat në banka arritën në vlerën 7.6 mld lekë në 31.12.2008, duke shënuar një rritje prej 1.5 mld lekë në krahasim me 31.12.2007 dhe duke përbërë zërin më të lartë të aktiveve të tregut në masën 49% të totalit të aktiveve. Rritja në zërin e depozitave vjen si pasojë e derdhjes së transhit të tretë të Fondit të Garancisë pranë bankave të nivelit të dytë. Bonot e Thesarit përbëjnë rreth 4% të totalit të aktiveve të tregut, duke e çuar kështu në 54% pjesën e aktiveve likuide.

Autoriteti ka verifikuar në fund të çdo tremujori nivelin e kërkuar të aftësisë paguese, aftësinë aktuale paguese (kapitalin) dhe investimin e tij. Aftësia aktuale paguese e tregut më 31.12.2008 është në vlerën 5,327,336,266 lekë nga 4,460,378,240 lekë që ishte më 31.12.2007.

Tabelë 7: Bilanci kontabël i tregut të sigurimeve

<i>Bilanci Kontabël i Tregut të Sigurimeve</i>	<i>31.12.2006</i>	<i>% ndaj totalit</i>	<i>31.12.2007</i>	<i>% ndaj totalit</i>	<i>31.12.2008</i>	<i>% ndaj totalit</i>
Depozita	3,233	28%	6,104	46%	7,601	49%
Toka dhe ndërtime	1,014	9%	1,001	7%	1,620	11%
Aksione dhe pjesëmarrje	949	8%	1,108	8%	1,339	9%
Bono Thesari	2,359	21%	1,330	10%	624	4%
Debitorë	1,120	10%	1,137	9%	1,168	7%
Aktive të tjera	2,776	24%	2,678	20%	3,175	20%
TOTALI I AKTIVIT	11,453	100%	13,358	100%	15,526	100%
Provigjonet teknike bruto	5,518	48%	5,928	44%	5,139	33%
Detyrime të tjera	378	3%	474	4%	1,554	10%
Kapitalet e veta	5,557	49%	6,956	52%	8,833	57%
TOTALI PASIVIT	11,453	100%	13,358	100%	15,526	100%

Treguesit financiarë IRIS

Në kuadrin e punës së Autoritetit për ngritjen e një tregu financiar të stabilizuar dhe në kuadrin e projektit të Autoritetit në bashkëpunim me Bankën Botërore, me synim kalimin në drejtim të metodës të mbikëqyrjes me bazë risku, gjatë vitit 2008 ka vazhduar të zbatohet sistemi i paralajmërimit të hershëm.

Tabelë 8: Diapazonet e vlerave të indikatorëve financiarë IRIS për tregun e sigurimeve

Raporti	31.12.2006	31.12.2007	31.12.2008	Kufiri (%)	
				MIN	MAX
Norma e rritjes së primit	13.22%	30.97%	19.31%	-40	40
Raporti i mbajtjes neto	89.35%	86.16%	80.38%	40	80
Raporti dëme/prime neto	35.65%	24.19%	25.78%	50	80
Raporti i shpenzimeve	56.06%	55.62%	64.84%	25	50
Raporti i kombinuar	91.71%	79.81%	90.62%	85	105
Te ardhurat nga investimet	7.55%	4.55%	6.69%	4	8
Raporti i kapitalit	75.03%	74.84%	75.28%	20	50
Raporti i provigjoneve teknike	79.85%	94.39%	89.95%	10	30
Raporti i aftësisë paguese	447.40%	539.19%	424.48%	150	300

Kështu, në analizën e gjendjes financiare të sektorit të sigurimeve, në vlerësimin e shoqërive, përdoren edhe treguesit e sistemit IRIS (Sistemi Informativ Rregullativ i Sigurimeve) të përshtatura për shoqëritë e sigurimit të jo-jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg.

Norma e rritjes së primeve të tregut të sigurimeve është brenda kufijve të përcaktuar. Kështu për vitin 2008, norma e rritjes së primeve të tregut është 19%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Raporti i mbajtjes neto ka pësuar ulje në kuadër tregu dhe për shoqëritë e jo-jetës. Normat e përcaktuara ndërkombëtare rekomandojnë vlera midis 40-80%, ndërkohë që në tregun shqiptar të sigurimeve raporti është në masën 80% për tregun e sigurimeve të jo-jetës për vitin 2008.


Raporti dëme/prime në nivel tregu, vazhdon të mbetet në nivele të ulëta; 27% për tregun e sigurimeve të jo-jetës dhe 13% për tregun e jetës për vitin 2008.

Raporti i shpenzimeve, vazhdon të jetë në përmasa jo normale për një shoqëri sigurimi, por ky përbën një fenomen për të gjithë tregun e sigurimeve. Ky raport është në masën 66% për tregun e sigurimeve të jo-jetës dhe 52% për tregun e sigurimeve të jetës. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve e zënë shpenzimet operative të veprimtarisë në masën 72% për tregun e jo-jetës dhe 81% për tregun e sigurimeve të jetës.

Raportet financiare për vitin 2008 jepen në grafikët e mëposhtëm për të gjitha shoqëritë e sigurimit.



Treguesit IRIS 2008



Inspektime në vend (on site) në subjektet e mbikëqyrura

Krahas analizës dokumentare, inspektimi në vend është një pjesë tepër e rëndësishme e procesit të mbikëqyrjes, e lidhur ngushtë me procesin e monitorimit të vazhdueshëm. Inspektimi furnizon me informacion plotësues analizimin e informacionit financiar dhe statistikor të raportuar nga operatorët e tregut dhe është një mënyrë e rëndësishme për të

verifikuar dhe identifikuar të dhënat e nevojshme, që ndihmojnë në procesin e vlerësimit të aftësisë paguese, duke matur ecurinë e parametrave që ndikojnë në këtë vlerësim, si dhe arsyet e kësaj ecurie.

Tregu i sigurimeve

Inspektimi i dëmeve të paguara dhe atyre pezull

Hapat e procesit të inspektimit

- Përcaktimi i qëllimit dhe formës së inspektimit
- Grumbullimi dhe shqyrtimi i të dhënave
- Hartimi i programit të inspektimit
- Emërimi i personelit inspektues
- Prezantimi i programit të inspektimit me drejtuesit e subjektit
- Kryerja e inspektimit
- Hartimi i projekt raportit të inspektimit
- Dërgimi i projekt raportit tek subjekti i inspektuar dhe marrja e opinionit
- Përgatitja e raportit përfundimtar

Inspektimet me objekt të kufizuar, kryesisht janë fokusuar në verifikimin në vend të procedurave të ndjekura nga shoqëritë e sigurimit në procesin e pranimit, trajtimit, vlerësimit dhe pagesës së dëmeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Pjesë e këtij inspektimi ishte edhe verifikimi i mënyrës së funksionimit të sistemit të trajtimit të ankesave dhe procedurat e ndjekura për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”. Problematika, gjetjet apo

mangësitë e konstatuara nga inspektimi, janë shoqëruar me një sërë vendimesh nga Bordi i AMF-së, që kishin të bënin kryesisht në marrjen e masave korrektive apo vendosjen e sanksioneve ndaj shoqërive të sigurimit, si dhe me dhënien e rekomandimeve, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit dhe administrimit të dëmeve.

Një rol të rëndësishëm në funksion të trajtimit të drejtë, ligjor e të paanshëm të të siguruarve, ka luajtur edhe hartimi e miratimi i Udhëzimit të Ministrit të Financave nr 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” si dhe Udhëzimi i AMF nr 6, datë 30.08.2007 “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”.

- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24, datë 15.11.2007 “Mbi trajtimin e dëmeve të mbuluara nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” trajton dëmet pasurore dhe jo pasurore të mbuluar nga kontratat e sigurimit të detyrueshëm, procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, vlerësimin e dëmit dhe mënyrat dhe afatet e likuidimit dhe kontabilizimit të dëmeve, si dhe mënyrën e trajtimit të ankesave nga policmbajtësit.
- Udhëzimi i AMF nr. 6, datë 30.08.2007 “Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime”, trajton parimet dhe rregullat e përgjithshme që duhet të zbatohen shoqëritë e sigurimit apo strukturat e tjera të autorizuara në trajtimin dhe vlerësimin e dëmeve.



Inspektimi i bilancit të shoqërive të sigurimit

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit, ka ushtruar inspektime në shoqëritë e sigurimit me qëllim:

- Verifikimin e aktiveve të shoqërive të sigurimit për vitin 2007 dhe tre mujorin e parë të vitit 2008.
- Mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike, me aktive, sipas kategorive të përcaktuara në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” dhe aktet nënligjore.
- Vlerësimin e cilësisë së aktiveve dhe nivelin e likuiditetit të tyre.
- Verifikimi i përgjegjësive të kontraktuara dhe risigurimeve të kryera sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, si dhe akteve përkatëse nënligjore.

Inspektimi në vend i bilancit ka siguruar një informacion tepër të nevojshëm, i cili shërbeu si bazë për analizën e gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit.

Inspektime të tjera në vend

Këto inspektime kanë konsistuar në verifikimin në vend të çështjeve apo problemeve që kanë dalë gjatë analizës të pasqyrave financiare periodike të shoqërive të sigurimit, apo për çështje të veçanta që kërkonin verifikim të menjëhershëm.

AMF, në vazhdimësi në vitin 2008, ka kryer inspektime tematike, me qëllim mbikëqyrjen e aspekteve të veçanta të veprimtarisë së shoqërive të sigurimit dhe agjentëve në sigurime, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës së sigurimeve dhe zbatimin e vendimeve të Bordit të AMF. Kështu, në bazë të rezultateve të inspektimit tematik për verifikimin e gjendjeve dhe lëvizjeve të depozitave qëllimore të ngurtësuara për fond garancie të shoqërive të sigurimit, një komunikim i vazhdueshëm është mbajtur me sistemin bankar nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, për të kërkuar që çdo lëvizje e depozitave qëllimore për fond garancie nuk duhet të kryhen pa marrë më parë miratimin e Autoritetit. Rezultatet e këtij bashkëpunimi kanë qenë pozitive, duke e rritur ndjeshëm cilësinë e informacionit dhe sigurinë për mosprekjen e fondit të garancisë. Në kuadër të marrjes dhe kryqëzimit të informacionit të nevojshëm për ushtrimin e mbikëqyrjes, një bashkëpunim i suksesshëm ka rezultuar dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Gjatë vitit 2008, janë ushtruar inspektime edhe në degët e shoqërive të sigurimit e në rritjen e ndërmjetësve në sigurime, me qëllim verifikimin në vend të zbatimit të dispozitave të legjislacionit të fushës së sigurimit të detyrueshëm.

Inspektime në vend në fondet private të pensioneve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim vlerësimin e gjendjes financiare të instituteve private të pensioneve në 31.12.2007 dhe 31.03.2008, ushtroi inspektim në fondet private të pensioneve në muajin prill të vitit 2008, për verifikimin e:

- zërave të aktiveve për vitin 2007 dhe tre mujorin e parë të vitit 2008,
- drejtimet e investimit të aktiveve,
- numrit të kontribuesve, kontratave individuale apo kolektive dhe të ardhurat nga kontributet e derdhura për vitin 2007,
- detyrimeve të instituteve private të pensioneve suplementare për vitin 2007 dhe tremujorin e parë të vitit 2008.

Inspektimi i kryer nxori një sërë problemesh si: plotësimi i fondit të garancisë dhe plotësimi i numrit minimal të kontribuesve, të cilat u shoqëruan me një sërë masash korrektive nga Bordi i AMF-së.

Inspektime në vend në shoqëritë e licencuara në fushën e letrave me vlerë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ushtruar inspektime në vend në shoqëritë e licencuara në fushën e letrave me vlerë "Kapital Invest" dhe "Posta Shqiptare", me qëllim verifikimin e ushtrimit të aktivitetit të tyre në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt".

Mbi bazën e rezultateve të inspektimit, një sërë rekomandimesh janë dhënë nga Bordi i Autoritetit, për një funksionim më të mirë të tyre.

Masat korrigjuese dhe administrative

Një treg financiar i qëndrueshëm, efikas dhe transparent, me operatorë të shëndoshë financiarisht, arrihet nëpërmjet shtimit apo forcimit të masave mbikëqyrëse. Kjo ka qenë një nga sfidat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me qëllim parandalimin dhe eliminimin në kohën e duhur të shkeljeve të subjekteve të mbikëqyrura. Gjatë vitit 2008, pavarësisht nga përpjekjet mbikëqyrëse të Autoritetit, janë krijuar situata ku disa subjekte financiare jo-bankare nuk kanë arritur parametrat konform kërkesave ligjore ose kanë përdorur praktika jo të sigurta. Strategjia e masave ka funksionuar në mënyrë të tillë, që sa më i pafavorshëm të ketë qenë profili i riskut aq më e madhe ka qenë shkalla e ndërhyrjes së mbikëqyrjes dhe me të mëdha kanë qenë masat korrigjuese dhe gjrobat, si mjete të papajtueshmërisë apo të sigurimit të kthimit në gjendje të sigurt dhe të shëndoshë. Masat mbikëqyrëse, masat korrigjuese dhe gjrobat, janë vendosur nga Autoriteti në mënyrë të paanshme, transparente duke reflektuar seriozitetin dhe profesionalizmin e mbikëqyrjes nga ana e Autoritetit. Gjithashtu, Autoriteti ka punuar me kujdes në drejtim të njohjes, identifikimit të riskut duke iniciuar masa përkatëse, me qëllim zbatimin e tyre në praktikën e përditshme. Masat e vendosura ndaj subjekteve të mbikëqyrura, kanë ndikuar në një përmirësim të pozitave financiare të disa subjekteve, si dhe kanë ndikuar në zvogëlimin e riskut.



Masat administrative të ndërmarra gjatë vitit 2008

Për shoqëritë e sigurimit

Gjatë vitit 2008, bazuar në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, si rezultat i shkeljeve të konstatuara nga analiza financiare periodike, inspektimit në vend (i pjesshëm dhe i plotë), Autoriteti ka ndërmarrë disa masa administrative duke zbatuar parimin e gradualizmit, i cili shtrihet duke filluar që nga masat korrigjuese, masa administrative ndaj personave përgjegjës deri në sanksion me gjobë, si mjetin më të fundit për të detyruar subjektet e mbikëqyruara për të eliminuar shkeljet. Llojet e masave janë bazuar në llojin e shkeljes, ekspozimin e riskut, shkeljes së përsëritur, etj.

Për institutet private të pensioneve

Autoriteti, i kufizuar nga legjislacioni në fuqi i veprimtarisë së instituteve private të pensioneve, Ligjit nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për Pensionet Suplementare dhe instituteve private të Pensioneve” (i ndryshuar), me qëllim stabilitetin financiar të këtyre subjekteve dhe mbrojtjen e interesave të aderuesve, ka pasur në vëmendje të veçantë ecurinë e instituteve private të pensioneve. Duke konsideruar shqetësuese problematikat e hasura gjatë mbikëqyrjes si: plotësimin e fondit të garancisë, plotësimin e numrit të aderuesve, mosprekjen e llogarive individuale të aderuesve, Autoriteti ka ndërmarrë gjatë vitit 2008 disa masa korrigjuese.

Tabelë 9: Masat administrative të marra nga AMF ndaj shoqërive të sigurimit dhe instituteve private të pensioneve

<i>Masa administrative ndaj</i>	<i>Numri</i>
Shoqërive të sigurimit	25
- Masa korrigjuese	11
- Masa administrative ndaj personit përgjegjës	1
- Sanksion me gjobë shoqërisë	4
- Sanksion me gjobë personit përgjegjës	2
- Plan masash financiare	6
- Refuzim licence për vlerësues dëmsh	1
Instituteve private të pensioneve	4
- Sanksion me gjobë	1
- Masa korrigjuese	3
TOTALI	29

Ndjekja e masave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Hapësirë Informimi

Masat administrative që parashikon Ligji nr. 9267, dt. 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime":

- Urdhër për eliminim shkëlqesh
- Masa korigjuese
- Plan financiar
- Gjobë subjektit
- Gjobë personit përgjegjës
- Pezullim personit përgjegjës
- Tërheqje licence (tërësore ose pjesore)
- Administrim i përkohshëm
- Likuidim
- Falimentim

Autoriteti, në mënyrë të vazhdueshme dhe transparente, ka ndjekur zbatimin e masave administrative sipas afateve të përcaktuara në vendimet e Bordit.

Ndjekjen e këtyre vendimeve, Autoriteti e ka konsideruar një proces të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për arritjen e qëndrueshmërisë financiare të subjekteve të mbikëqyrura.

Autoriteti, gjatë vitit 2008, ka përcaktuar procedura mjaft të qarta, duke bërë një filtrim të fenomeneve, objekt i proceseve gjyqësore, si dhe ka ndjekur arkëtimet e sanksioneve të vendosura me gjobë (si ato të vendosura gjatë vitit 2008 ashtu dhe ato të prapambetura).

Një nga vështirësitë e hasura gjatë ecurive të proceseve gjyqësore që kanë lidhje me sanksionet e vendosura shoqërive të sigurimit është fakti se nga ana e organeve gjyqësore nuk ka një njohje specifike të problemeve teknike që paraqiten në këte fushë, probleme të cilat kanë qenë dhe objekti kryesor i sanksioneve të vendosura.

Tabelë 10: Tabelë përmbledhëse e statusit aktual të sanksioneve të vendosura me gjobë

	<i>Numër</i>	<i>Shuma totale e gjobave (në lekë)</i>
Gjopa të paguara gjatë vitit 2008 nga	12	11,200,000
Vendime të vitit 2008	7	7,400,000
Vendime të viteve paraardhëse*	5	3,800,000
- Të mbartura	2	800,000
- Të fituara me proces gjyqësor	2	2,000,000
- Tërhequr kërkesëpadia	1	1,000,000
- Procese gjyqësore ende në vazhdim**	4	4,400,000

Shënime:
 * këto sanksione i përkasin viteve 2005 - 2007
 ** tre nga këto procese janë në Gjykatën e Apelit dhe një në Gjykatën e Lartë



2.4 Teknologjia e informacionit

Teknologjia e Informacionit (TI) në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare është në zhvillim të vazhdueshëm si pjesë e pandarë e Institucionit, duke pasur si objekt pune dhe strategji zhvillimi projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e strukturës informatike të brendshme dhe të shërbimeve. Qëllimi i aktivitetit të Autoritetit është përmbushja e nevojave të mbikëqyrjes së tregjeve nën kompetencë, operatorëve të tyre, si dhe mbrojtja e konsumatorëve nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjeve rregullatorë. Viti 2008 është shoqëruar me një zhvillim cilësor si në organizimin e strukturës së brendshme ashtu dhe në projektimin, ndërtimin dhe administrimin e sistemeve informatike në mbështetje të strategjisë së Autoritetit.

Në kuadër të përmirësimit të aktivitetit të brendshëm TI siguron administrimin e vazhdueshëm në nivel aplikimi, databazash, menaxhimin e sigurisë dhe ndihmën e vazhdueshme teknologjike për punonjësit e institucionit.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Ndër projektet më të rëndësishëm të dy vjeçarit 2007 - 2008, është Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik. Gjatë 2008 është realizuar me sukses faza e parë e tij, Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshëm Motorik dhe është në vazhdim dhe faza e dytë e tij me Regjistrin e Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike. Për të mundësuar fazën e tretë të projektit, krijimin e sistemit Bonus Malus, Regjistri i Dëmeve do të plotësohet me të dhënat historike të dëmeve për tre vitet e fundit. Sistemi i ndërtuar në bashkëpunim me Shoqëritë e Sigurimit përpunon tërësinë e informacionit të nevojshëm si pjesë e aktivitetit të institucionit, ndërkohë që garanton stabilitet, siguri dhe vazhdueshmëri të proceseve të punës të pjesëmarrësve të tregut.

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik

Faza I: Regjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike

Regjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorike përbën një platformë raportimi dhe identifikimi të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik në formën e Përgjegjësisë ndaj Palëve të Treta, Kartonit Jeshil dhe Sigurimit Kufitar në përdorim nga data 1 dhjetor 2007 dhe në mirëmbajtje të suksesshme pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2008. Në regjistrin e sigurimeve, regjistrohen detaje të policave të sigurimeve të detyrueshme motorike të lëshuara nga shoqëritë e sigurimit. Pjesë e procesit është dhe lëshimi i një numri unik në kohë reale nga serveri qendror, i cili realizon identifikimin e policave, duke mundësuar kështu dhe shmangien e abuzimeve me natyrë falsifikuese ose mos raportimit të policave.

Faza II: Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike

Regjistri i Dëmeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike përbën një platformë në të cilën raportohen online

dëmet e ndodhura në kuadër të sigurimeve të detyrueshme motorike. Regjistri i Dëmeve krijohet me qëllim kryesor mundësimin e aplikimit të sistemit Bonus Malus duke përdorur si një nga parametrat e tij 'historikun e dëmeve'. Ekzistenca e një baze historike të dhënash mbi dëmet mundëson liberalizimin e mundshëm të tarifave ose kalimin e mirëfilltë në përjasjen "Risk-Based" për përlogaritjen e kapitalit minimal të kërkuar për këto portofole në varësi të riskut të marrë në sigurim. Në këtë regjistër do të mundësohen raporte të ndryshme statistikore, të cilët do të mundësojnë një pamje më të qartë dhe më të detajuar mbi përmbajtjen dhe aktivitetin tij.

Faza III: Sistemi Bonus Malus

Në Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik, një rol të rëndësishëm në të ardhmen do të luajë dhe mundësimi i sistemit Bonus Malus, me fokusim të veçantë mbi liberalizim të mundshëm të tarifave ose kalim të mirëfilltë në përjasjen "Risk-Based". Të dhënat, rezultat i fazës së parë dhe të dytë të projektit, janë parashikuar të përdoren si parametra në algoritmet e mundshme "Bonus-Malus". Gjatë vitit 2008 është projektuar zgjidhja teknike dhe integrimi i mundshëm i saj me Regjistrin Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorike.

Përveç aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të suportit të vazhdueshëm teknik, përmirësimit të testimit, kontrollit automatik të shërbimeve dhe aksesit në sistem nga ana e shoqërive të sigurimit, gjatë vitit 2008, është mundësuar projektimi dhe implementimi në sistem i ndryshimeve të kërkuara në urdhërin e Ministrisë së Financave nr. 82, datë 19 qershor 2008 duke bashkërenduar punën e shoqërive të sigurimit në mënyrë që aplikimi i ndryshimeve të garantonte vazhdimësinë e shërbimit.

Në kuadër të raportimit është mundësuar automatizimi i raportimit ditor e javor i ndarjes së tregut dhe krijimi i raporteve krahasuese midis të dhënave të policave dhe të dhënave të Drejtorisë të Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRr).

Në lidhje me fazën e dytë për ndërtimin e regjistrit të dëmeve, projekti është përgatitur nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit, në përshtatje me rregulloret dhe udhëzimet e miratuara nga Bordi në lidhje me trajtimin e dëmeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zbatueshmërisë dhe Departamentin e Çështjeve Juridike, duke integruar me shoqëritë e sigurimit dhe duke përmbledhur eksperiencën e tyre dhe të partnerëve internacionale si ISVAP në Itali e Tramer në Turqi, si dhe me mbështetjen e Bankës Botërore.

Projekti pas aprovimit të tij nga Bordi i AMF, aktualisht është në proces dhe parashikohet të përfundohet në tremujorin e parë të vitit 2009.

Motori i kërkimit të policave për institucionet

Në përmbushje të marrëveshjes midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit për "Aksesin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit në Regjistrin Elektronik



Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik”, lidhur në datë 22.05.2008, në Tiranë, u ndërtua dhe është në mirëmbajtje “Motori i kërkimit të policave për institucionet” i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet aksesit të sigurt nga faqja e internetit e Autoritetit dhe me rezultat, dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo të mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Të dhënat e gjetura dhe të shfaqura në bazë të marrëveshjes midis institucioneve, i referohen Regjistrimit Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe si të tilla mbulojnë sigurimet e detyrueshme të kontraktuara pas datës 01.12.2007. Aksesi dhe kërkimet e kryera janë të audituara.

Motori i kërkimit të policave për qytetarët

Në kuadër të aktiviteteve, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve dhe rritjen e transparencës së veprimtarisë të sigurimeve të detyrueshme, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, gjatë vitit 2008, vendosi mundësimin e kërkimit nga qytetarët të vlefshmërisë të policave në përkatësi.

Autoriteti projekttoi, ndërtoi dhe ka në mirëmbajtje “Motorin e kërkimit të policave për qytetarët” i cili mundëson kërkimin e policave nëpërmjet faqes së internetit të Autoritetit (<http://www.amf.gov.al/mtpl.asp>) dhe me dhënien e konfirmimit të mbulimit në sigurim me Karton Jeshil ose TPL për automjetet shqiptare apo mjeteve të huaja me Policë Kufitare.

Të dhënat e gjetura i referohen Regjistrimit Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik dhe si të tilla mbulojnë sigurimet e detyrueshme të kontraktuara pas datës 01.12.2007. Kërkimet e kryera janë të kontrolluara.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

Në kuadër të përmirësimit të raportimit elektronik të subjekteve në mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me ndihmën financiare të Bankës Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH), po zhvillon projektin “Management Information System” (MIS).

Projekti nga ana teknike përbëhet nga një platformë raportimi web, nëpërmjet të cilës operatorët e mbikëqyrur raportojnë të dhënat e kërkuara nga Autoriteti në mënyrë elektronike. Autoriteti ka marrë pjesë intensive në identifikimin e platformës hardware dhe specifikave të rrjetit, për të mundësuar përdorimin e sistemit, i cili aktualisht është në ndërtim. Elementët hardware të nevojshëm, janë tashmë të instaluar në sallën e serverave të Autoritetit dhe të gatshëm për t'u përdorur nga shoqëria zbatuese.

Platformat dhe sistemet e AMF-së garantojnë

Në drejtim të mbikëqyrjes

- Monitorimin në kohë reale të shoqërive të sigurimit në shitjen e policave të sigurimeve të detyrueshme.
- Kontrollin e korrektësisë së policave nga vetë klientët.
- Automatizimin e proceseve të punës dhe rritjen e efektivitetit dhe vendimmarrjes.
- Minimizimin e gabimeve teknike nëpërmjet njësitit të përdorimit të platformave të ndryshme nga AMF dhe operatorët e mbikëqyrur.
- Parametra të lartë të sigurisë, si nga ana fizike dhe funksionale.

Në drejtim të efektivitetit të punës së institucionit

- Standardizimin e infrastrukturës të rrjetit dhe të menaxhimit informatik të posteve të punës.
- Forcimin e shkallës së sigurisë së informacionit, duke marrë parasysh sistemet kritikë të ndërtuar dhe konfidencialitetin e të dhënave, nëpërmjet rritjes të sigurisë të infrastrukturës informatike dhe aplikimit të rregullave në aksesin dhe përdorimin e brendshëm.
- Licencimin software për aktivitetin informatik të AMF, në bashkëpunim dhe sipas direktivave të institucioneve dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përdorimin e “paketave software” të standardizuara në aktivitetin financiar të AMF dhe të njohura nga organet e kontrollit apo ato tatimore, duke bërë më transparent funksionimin e vetë Autoritetit.
- Informatizimin e vazhdueshëm të arkivës, si dhe dokumentacionit të protokolluar për të lehtësuar dhe mundësuar vazhdueshmërinë e përpunimit të materialeve me afate shqyrtimi relativisht të gjata.
- Automatizimin e procesit të vendosjes së të dhënave, nëpërmjet integritit të produkteve më të avancuara, me rrjedhojë efektivitetin e lartë në përdorimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e tyre profesionale.

2.5 Bashkëpunimi institucional



Zj. E. Gjoni dhe Z. R. Bode në prezantimin e projektligjit mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit

Bashkëpunimi me institucionet e vendit

AMF mban në mënyrë të vazhdueshme bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, në përmbushje të misionit të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe të rritjes së efektivitetit të rregullimit të tregjeve financiare në Shqipëri.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave është konkretizuar gjatë vitit 2008 dhe me hartimin e Projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili tashmë është dekretuar

nga Presidenti i Republikës dhe përbën reformën më të rëndësishme ligjore në fushën e sigurimeve të detyrueshme, që nga viti 1992. Bashkëpunimi ka vijuar edhe në përmirësimin në përgjithësi të kuadrit ligjor të tre sektorëve që mbikëqyren nga AMF.



Banka e Shqipërisë mbetet një nga partnerët kryesorë të AMF-së në arritjen e objektivave të përbashkëta për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare në vend. Evoluimi i produkteve financiare dhe ndërthurja e veprimtarive të fushave të ndryshme të sektorit financiar e bën tepër të domosdoshme bashkëpunimin midis të dy institucioneve rregullatore. Në vitin 2008, shkëmbimi i informacionit në funksion të mbikëqyrjes së tregjeve financiare në vend, ka rezultuar i efektshëm në evidentimin e nivelit të riskut të mbartur dhe transferuar brenda sektorit financiar. Ky bashkëpunim gjatë vitit 2008 ka hyrë në një fazë të re, në kuadrin e zbatimit nga AMF të platformave teknologjike, ku dhe janë zhvilluar takime zyrtare midis specialistëve të të dy institucioneve, në lidhje me përcaktimin e formave dhe llojin e informacionit që do të shkëmbehet.



Gjatë prezantimit të projektligjit mbi sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit

Në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, AMF ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Integritimit në funksion të plotësimit të këtyre angazhimeve. Të gjitha ndryshimet ligjore që u miratuan gjatë vitit 2008 kanë reflektuar në masë të madhe kërkesat e direktivave Evropiane në fushat e sigurimeve, pensioneve dhe letrave me vlerë.

Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare

Zhvillimi i tregjeve ndërkombëtare financiare me ritme të shpejta, unifikimi i standardeve rregulluese dhe mbikëqyrëse, është shoqëruar me angazhimin e rregullatorëve të vendeve të ndryshme për zbatimin e këtyre “parimeve të përgjithshme”. Në këtë frymë, AMF ka intensifikuar kontaktet dhe shkëmbimin e eksperiencës me homologët dhe vazhdon të ketë një pjesëmarrje gjithnjë e më shumë aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtarë. Bashkëpunimi ndërkombëtar bëhet akoma më i rëndësishëm për shkak të nevojës së futjes në zbatim të direktivave të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare

AMF është anëtare e 3 shoqatave ndërkombëtare të rregullatorëve të sigurimeve (IAIS), letrave me vlerë (IOSCO) dhe pensioneve (IOPS) dhe ka marrëdhënie e bashkëpunim të ngushtë me një numër të madh rregullatorësh në botë. AMF është pjesëmarrëse, me kontribut aktiv, në Nënkomitetin e Bazës së të Dhënave të Ligjeve të IAIS-it. Synimi i

funksonimit të kësaj strukture lidhet me shkëmbimin e përvojave të vendeve të ndryshme, hartimin dhe njësimin e standardeve për t'u zbatuar më tej nga të gjithë vendet anëtare. Ndërkohë gjatë vitit 2008 është bërë një punë intensive për t'u bërë pjesë e Marrëveshjes Multilaterale të Mirëkuptimit me IOSCO.



Zj. Elisabeta Gjoni dhe Z. Hashim Rexhepi në nënshkrimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit

Bashkëpunimi me institucione homologe

AMF mban një komunikim të vazhdueshëm me institucione homologe në rajon e më gjerë, në kuadër të plotësimit të rolit të saj si një rregullator i tregjeve financiare jo-bankare. Viti 2008 shënoi një zhvillim të rëndësishëm në këtë drejtim, ku u dhe u arrit nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BOK). Kjo marrëveshje u bë e domosdoshme pas ristrukturimit të rregullatorëve financiarë të të dy vendeve, dhe plotësoi memorandumin e

mëparshëm në fushën e sigurimeve me bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit edhe në sektorët e tjerë financiarë jo bankarë, si ai i pensioneve dhe i letrave me vlerë. Bashkëpunimi midis të dy institucioneve ka qenë i pandërprerë dhe shumë efektiv, ndërkohë që marrëveshja e nënshkruar rrit edhe më tej mundësitë dhe hapësirat në shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit, ekspertizës dhe përvojës.

AMF ka përforcuar më tej komunikimin dhe bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë në funksion të mbarëvajtjes së sektorëve në të dy vendet. Pas përfshirjes së interesave Austriake në tregun Shqiptar të sigurimeve, ky bashkëpunim ka qenë tepër i domosdoshëm dhe i efektshëm, duke u konkretizuar dhe në takime të ndryshme pune dhe shkëmbime eksperience midis përfaqësuesve të të dy institucioneve. Një bashkëpunim i suksesshëm në drejtim të shkëmbimit të eksperiencës ka rezultuar dhe ai me Autoritetin Sloven, bashkëpunim i cili është konkretizuar me vizita pune për marrjen e eksperiencës slovene në drejtim të zbatimit të platformës elektronike të raportimit, që AMF është duke vënë në zbatim.

Bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët

Marrëdhëniet me donatorët vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin e realizimit të projekteve strategjike të AMF-së në kuadrin e ngritjes institucionale, nxitjes dhe zhvillimit të hallkave të veçanta të aktivitetit të institucionit.

Banka Botërore vazhdon të mbetet një nga partnerët strategjikë të AMF. Bashkëpunimi i nisur që në fillimet e AMF, tashmë ka arritur një fazë konsolidimi, ku projektet e nisura në drejtim të përmirësimit të bazës ligjore dhe metodologjisë së mbikëqyrjes, janë



drejt përfundimit me sukses. Përfitimet e këtyre projekteve pritet të ndihen në vitet në vazhdim, në kuadër të përfundimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator. Një produkt tepër i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi, ka qenë dhe hartimi nën asistencën e Bankës Botërore i projektligjit për fondet e pensionit vullnetar.

Në kuadër të bashkëpunimit, **FMN** ka dhënë rekomandime të vlefshme për hapat që duhen hedhur deri në krijimin e kuadrit të plotë ligjor dhe hartimin e strategjisë së pensioneve private në Shqipëri. Autoriteti ka konkretizuar këto rekomandime me hartimin e projektligjit “Mbi fondet e pensionit vullnetar”.

Procesi i përafrimit të legjislacionit me direktivat Evropiane në sistemin financiar në Shqipëri ka përfunduar më tej bashkëpunimin e AMF-së me strukturat e **Evropës së Bashkuar**. Ky bashkëpunim është konkretizuar në misionet ekspertësh dhe asistencë të ofruara nga instrumenti TAIEX në fushat e sigurimeve dhe pensioneve.

AMF vazhdon të mbajë një bashkëpunim të suksesshëm me **USAID** dhe me **Programin PFS**, bashkëpunim i cili ka mundësuar organizimin dhe pjesëmarrjen e stafit të AMF në një sërë evenimentesh dhe trajnimesh, ndër të cilat mund të përmendet pjesëmarrja e aktuarëve dhe specialistëve të tjerë të Autoritetit në trajnime jashtë vendit.

Bashkëpunimi me FSVK (Financial Services Volunteer Corps) vazhdon të jetë i suksesshëm, ku në veçanti gjatë vitit 2008 u konkretizua me zhvillimin e projekteve mbi zbatimin e projektligjit të Fondit të Investimeve dhe projekt-rregulloreve të Bursës.

Bashkëpunimi me Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) ka qenë tepër i rëndësishëm, ku dhe është hartuar projektligji mbi Obligacionet e Shoqërive Aksionere dhe Bashkive, i cili pritet që të sjellë një ndikim pozitiv në zhvillimin e tregut të titujve në Shqipëri. Një projekt tjetër tepër i rëndësishëm, ai i zhvillimit të një platforme të menaxhimit të informacionit për raportimin periodik të institucioneve financiare jo bankare ka nisur punën, ku dhe është mbyllur me sukses Faza II, nga katër faza të parashikuara deri në mbylljen me sukses të të gjithë projektit.

2.6 Marrëdhëniet me publikun, transparenca

Rritja e transparencës, komunikimi efektiv me publikun dhe edukimi financiar i tij, mbeten prioritet në vazhdim i AMF, në përmbushje të rolit themelor: Mbrojtjes së konsumatorit. Një konsumator, i cili disponon njohuritë bazë dhe informacionin e duhur, është në gjendje të përzgjedhë produktin që i përgjigjet më mirë nevojave të tij.

AMF praktikon një sërë formash dhe mënyrash në përmbushjen e një komunikimi efektiv me publikun, ku mund të përmenden fletëpalosjet që përmbajnë informacion të bollshëm dhe të strukturuar edukativ dhe statistikor, të përmbledhur për tregjet nën juridiksionin e AMF,



publikimet e ndryshme në funksion të rritjes së transparencës si dhe një faqe interneti interaktive, që mbetet instrumenti kryesor i komunikimit me të gjitha palët e interesit.

Viti 2008, ka qenë dhe viti i risive për sa i takon publikimeve të reja me informacion teknik dhe të specializuar. Puna e vazhdueshme për rritjen e gamës dhe cilësisë së informacionit, me qëllim përfshirjen e sa më shumë përdoruesve, është konkretizuar me hartimin dhe publikimin për herë të parë të:

- Raportit të Mbikëqyrjes për Tregun e Sigurimeve
- Gjeografisë së Sigurimeve
- Raportit Statistikor të Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë

Raporti i Mbikëqyrjes për Tregun e Sigurimeve ka ardhur si rezultat i kërkesave gjithnjë e në rritje të tregut për informacion të specializuar me karakter financiar, dinamikës së zhvillimit të tij, si dhe forcimit të transparencës nga ana e AMF në komunikimin me publikun. Në thelb të këtij raporti është informacioni statistikor-financiar i detajuar dhe tepër i strukturuar. Një strukturim i tillë plotësoi vakumin e deritanishëm për informacion me karakter tekniko-financiar. Kështu, përveç testeve IRIS për tregun, të dhënave makro dhe informacionit tekniko-financiar për tregun e sigurimeve të Jetës dhe të Jo-Jetës, një vend të rëndësishëm zënë dhe treguesit tekniko-financiarë të disa prej portofoleve me peshë më të rëndësishme, me qëllim analizimin e tendencave në vite. Përdoruesit e këtij publikimi mendohet të jenë të shumtë, duke filluar që nga vetë operatorët e tregut, investitorët e huaj, analistët e ndryshëm dhe deri për qëllime akademike.

Gjeografia e Sigurimeve është një publikim statistikor, në thelb të të cilit përfshihet informacioni mbi shpërndarjen e primeve dhe produkteve të sigurimit sipas prefekturave, i shoqëruar me informacion mbi dendësinë e sigurimeve (pra primi i sigurimit për frymë sipas prefekturave). Një strukturim i tillë i informacionit bën të mundur analizimin më të mirë të tregut të sigurimeve sipas zonave gjeografike, duke i ardhur në ndihmë mbikëqyrjes në lidhje me evidentimin e përqendrimit të tregut, vete operatorëve të tregut si dhe studiuesve të pavarur. Në një këndvështrim afatmesëm sistemimi i të dhënave në këtë formë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i raportimit nga operatorët në tregun e sigurimeve mund t'i hapë rrugën publikimeve më komplekse të strukturuar jo vetëm për qëllime informative, por edhe për analiza të mirëfillta të shpërndarjes së risqeve, tarifimit të produkteve dhe mbulimeve nga katastrofat sipas zonave gjeografike. Ky përmirësim do të mbështetet nga një sistem elektronik raportimi dhe përpunimi të të dhënave, për të cilin AMF është duke punuar.

Raporti Statistikor i Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë përmban informacion të strukturuar në lidhje me segmentin e tregut të letrave me vlerë të Qeverisë, i cili është nën mbikëqyrjen e AMF. Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu sekondar i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të subjekteve të licencuara për kryerjen e transaksioneve në këto instrumente me investitorët. Krahas



rubrikës GSRM, publiku tashmë ka në dorë një raport dinamik që jep informacion të detajuar në lidhje me këtë segment të tregut të letrave me vlerë të Qeverisë.

Gjatë këtyre dy viteve, që me krijimin e AMF-së, në sajë të një pune të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së informacionit dhe transmetimit të tij në forma dhe mënyra që u përshtaten përdoruesve të ndryshëm, mund të thuhet që komunikimi me publikun ka arritur një fazë konsolidimi. Tashmë vizitorët e ndryshëm gjejnë në faqen zyrtare të AMF-së, www.amf.gov.al, informacion të larmishëm mbi zhvillimet e fundit të tregjeve financiare jo-bankare dhe një sërë rubrikash interaktive që i përshtaten më së miri nevojave të publikut për informacion. Gjatë vitit 2008, faqja zyrtare e AMF-së, shënoi një numër të konsiderueshëm vizitorësh në rritje, gati 20% më shumë se një vit më parë. Gjatë vitit 2008, faqja zyrtare e AMF shënoi më shumë se 34 mijë vizita nga 80 vende të ndryshme të botës.

Raportet periodike statistikore e financiare pasqyrojnë dinamikën e zhvillimit të tregjeve financiare jo bankare, duke dhënë një pamje të qartë të ecurisë së këtyre tregjeve dhe duke plotësuar tashmë nevojat e shumta për informacion me karakter tekniko - financiar.

Oendra e Rregjistrimit të Sigurimeve Motorike, edhe në 2008, shënon rritje të shërbimit cilësor ndaj publikut, ku AMF u mundëson mbajtësve të mjeteve motorike, verifikimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nëpërmjet rubrikës “Verifiko policën tënde”, duke u dhënë njëkohësisht edhe orientimet përkatëse për të bërë korrektimet e nevojshme.

Projektet ligjore në proces kanë hapësirën e tyre në faqen zyrtare të AMF dhe publikimi i tyre para miratimit vazhdon të mbetet një mënyrë efikase dhe transparente komunikimi në mbledhjen e komenteve, apo sugjerimeve të ndryshme nga të gjitha palët e interesit dhe publikut të gjerë. Periodiku elektronik mujor i AMF, përmban informacione të larmishme të zhvillimit të sektorit financiar jo-bankar në Shqipëri, njohuri mbi praktikat më të mira të përshtatura nga tregjet e ndryshme dhe shoqatat ndërkombëtare të rregullatorëve në vende të ndryshme të botës.

AMF e konsideron tepër të rëndësishëm edukimin dhe informimin e publikut, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë përditësimit të faqes zyrtare me informacione të rëndësishme që lidhen me aktivitetin e AMF-së dhe Bordit, lajme dhe njoftime me karakter orientues dhe mbrojtës për publikun, informacione të mirëfillta edukuese për produktet financiare jo bankare dhe rëndësinë e tyre. Krahas pasqyrit të transparent të aktivitetit mbikëqyrës e rregullues, AMF ka qenë gjithashtu aktive në median e shkruar dhe elektronike, ku përveç fushatave sensibilizuese në kuadër të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit, mbahet një komunikim i vazhdueshëm në funksion të rritjes së transparencës për zhvillimet më të fundit në tregjet financiare jo bankare.

Faqja zyrtare e AMF-së i jep mundësi edhe përdoruesit të huaj të marrë informacionin e dëshiruar, pasi ajo është e organizuar në dy gjuhë, Shqip dhe Anglisht. Jo të pakta kanë qenë referencat e publikuesve, shoqatave, të interesuarve të ndryshëm në lidhje me tregun financiar jo bankar, të cilët kanë gjetur informacionin e kërkuar në faqen zyrtare të AMF-së. Përmendim këtu raportin e fundit mbi tregun e sigurimeve të Jo Jetës në Shqipëri të Kompanisë Britanike AXCO, e specializuar në analizën e tregjeve.

Kapitulli 3

Mbrojtja e Konsumatorit

Mbrojtja konsumatore një nga prioritetet strategjike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Ndër 9 parimet e IAIS, për ushtrimin e aktivitetit sigurues, veçohen:

Parimi 4: Transparenca e Informacionit ndaj Konsumatorit

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet t'i kushtojnë kujdesin e duhur informacionit të nevojshëm për konsumatorët e tyre si dhe t'i trajtojnë ata në mënyrë të drejtë.

Parimi 7: Marrëdhënia me Rregullatorin

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet të sillen me rregullatorët e tyre në mënyrë të hapur dhe bashkëpunuese.

Parimi 8: Ankimimi

Shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësit duhet të mbështesin një sistem për trajtimin e ankimeve në rast se ato janë të aplikueshme.

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, Autoriteti gjithnjë dhe më tepër ka synuar në rritjen e rolit të tij si mbrojtës dhe garantues të interesave të konsumatorëve. Konsumatori, nën juridiksionin e AMF-së, është i siguruari, investitori dhe kontribuesi në skemat vullnetare të pensioneve.

Gjatë vitit 2008, AMF ka punuar në vazhdimësi që konsumatori të jetë një individ i mirinformuar, vetpërcaktues, si dhe të jetë në gjendje të orientohet drejt në treg, proces ky që kushtëzohet gjithashtu edhe nga një mbikëqyrje bashkëkohore dhe transparente e tregjeve. Po kështu, vizioni i strategjisë së AMF-së ka qenë dhe mbrojtja e cënimit të të siguruarve ndaj rreziqeve të cilat ato vetë nuk mund t'i trajtojnë.

Kuadri ligjor i aktiviteteve të sigurimit dhe risigurimit parashikon një sërë masash për mbrojtjen e konsumatorit, por është konstatuar që akoma ka vend për përmirësime. Në këtë kuadër, në ndihmë të konsumatorëve, gjatë kësaj periudhe, ka funksionuar pa ndërprerje njësi e mbrojtjes konsumatore, e cila ka trajtuar ankesat për të gjitha rastet që paraqiten, si për vonesat në trajtimin e dëmeve, për ankesa ndaj refuzimit apo masës së dëmshpërblimit.

Procedurat e AMF-së fillojnë që me njohjen e praktikës së dëmit, sugjerimet ndaj shoqërisë së sigurimit për trajtim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontakte të vazhdueshme

me shoqërinë e sigurimit për zgjidhje sa më optimale të çështjes së ankimuar. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, AMF kthen pranë shoqërisë për rishikim çështjen e ankimuar, dhe më tej, nëse çështja nuk zgjidhet, rruga e fundit për zgjidhjen e konfliktit është procedura që parashikon Kodi i Procedurës Civile.

Gjatë vitit 2008, janë trajtuar 68 ankesa, kryesisht në lidhje me refuzimin e dëmshpërblimit apo masën e tij nga ana e shoqërive të sigurimit, dhe më së shumti kanë të bëjnë me kontrata të sigurimit TPL e brendshme, Garanci Kontrate dhe Shëndeti në Udhëtim. Nga këto ankesa janë zgjidhur përfundimisht rreth 30% e tyre. Komunikimi dhe transparenca ndaj publikut përbën dhe një nga mjetet në funksion të mbrojtjes konsumatore.



Objektivi i këtij përcaktimi, është që konsumatori të informohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që ai të jetë në gjendje të përzgjedhë dhe të vlerësojë situatën që i paraqitet.

Në lidhje me këtë, Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe aktet e tjera nënligjore, detyrojnë shoqëritë e sigurimit t’i ofrojnë konsumatorit informacionin e përditësuar, në lidhje me produktet e sigurimit, kushtet e kontratës, me zgjidhjen e plotë dhe të pjesshme të kontratës, përfitimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, primet, etj.

AMF, në mënyrë të vazhdueshme, informon konsumatorin (nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar) për krijimin e njësisë për mbrojtjen e konsumatorit, pranë të cilës çdo person mund të drejtohet për të kërkuar sqarime në lidhje me kontratat e sigurimit.

Gjithashtu, në faqen zyrtare të AMF-së, çdo person i siguruar mund të verifikojë nëpërmjet Qendrës Kombëtare të të dhënave të sigurimit të detyrueshëm MTPL, vlefshmërinë e policës së tij të sigurimit. Po kështu, në këtë faqe, gjendet Sistemi GSRM, (Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë), i cili i ka çelur një dritare publikut për t’u lidhur drejtpërdrejt me zhvillimet e fundit të tregut të letrave me vlerë.


PJESA II TREGJET E MBIKËQYRURA

II.1 Tregu i sigurimeve

Vështrim i përgjithshëm

Gjatë vitit 2008 vijuan veprimtarinë e tyre dhjetë shoqëritë e sigurimeve, nga të cilat shtatë shoqëri të sigurimit të jo-jetës, dy shoqëri të sigurimit të jetës dhe një shoqëri kompozite e jetës dhe jo-jetës.

Zhvillimi i tregut të sigurimeve në vite (në milionë lekë)



Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve arritën shifrën 7.08 miliardë lekë, ose rreth 19% më shumë se shifra përkatëse e vitit 2007. Viti 2008 shënoi një ndryshim të strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 44% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 56% të tregut, ku në krahasim me dy vitet e mëparshme primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin nga 65% dhe 70% të tregut.

Megjithatë, vlen të përmendim, që zhvillimi i sektorit mbetet ende larg potencialeve që ofron vendi dhe niveleve të zhvillimit në vende të tjera të rajonit. Pavarësisht rritjes që shënuan sigurimet e jetës, sërish 93% e primeve u gjenerua nga sigurimet e jo-jetës.


Në vitin 2008 u nënshkruan rreth 692 mijë kontrata sigurimi, ose rreth 27% më shumë se në vitin 2007.



Tabelë 11: Primet e shkruara bruto 2008

Lloji i sigurimit	Numri i kontratave	Primet e Shkruara Bruto	
		(në mln lekë)	(konvertuar në mijë euro)
A Sigurime të detyrueshme	363,363	3,995	32,538
B Sigurime vullnetare	328,971	3,082	25,102
B1 Sigurimi i jetës	58,392	515	4,196
B2 Sigurimi i jo-jetës	270,579	2,567	20,906
GJITHSEJ	692,334	7,076	57,640


Struktura e tregut të sigurimeve në 2008



Sigurimet e detyrueshme

Gjatë vitit 2008, sigurimet e detyrueshme motorike (të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta) vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë rreth 56% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve. Ligji **“Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”** zgjeron gamën e produkteve të sigurimit të detyrueshëm me dy produkte të reja: sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, si dhe sigurimin e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese. Në fokus të ligjit është përcaktimi i qartë i rregullave në mbrojtje të palëve të treta, të dëmtuara nga aksidentet dhe të gjithë konsumatorëve të policave të sigurimit të detyrueshëm, duke bërë një reformë të vërtetë ligjore, në funksion të këtij qëllimi. Ky ligj, i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, do të luajë një rol kyç për stabilizimin dhe

Zhvillimi i sigurimeve të detyrueshme në vite



përmirësimin e situatës së tregut të sigurimeve të detyrueshme.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në vitin 2008, arritën në rreth 2.73 miliardë lekë, ose rreth 6% më shumë se në 2007.

Në vitin 2008, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin rreth 940 milionë lekë, ose rreth 19% më shumë se në vitin 2007. Çmimet fikse të këtij produkti janë të detyrueshme për operatorët në treg.


Primet e kontratës së sigurimit kuftar gjatë vitit 2008 arritën në rreth 323 milionë lekë, apo rreth 36% më pak se në vitin 2007. Efekti vjen nga ulja e tarifave të shitjes të këtij lloji sigurimi sipas Urdhrit nr. 70, datë 20.07.2007 të Ministrit të Financave.

Sigurimet vullnetare

Në vitin 2008, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në rreth 3 miliardë lekë, ose 48% më shumë se të ardhurat e një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj kryesisht në infrastrukturë.



Zhvillimi i sigurimeve vullnetare të jo-jetës në vite



Në sigurimet vullnetare të jo-jetës, me të ardhura rreth 2.6 miliardë lekë, vendin e parë e zunë sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me rreth 31%, të pasuara nga sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 28% të të ardhurave të këtij grupi, sigurimi kasko me rreth 20% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në 2008 arritën në rreth 313 milionë lekë, ose rreth 68% më shumë se në vitin 2007. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 70% të të ardhurave të këtij grupi. Investimet e huaja në sigurime, në 2008, u shoqëruan me interesin për futjen e produkteve të reja kryesisht në fushën e shëndetit.

Primet në sigurimet e jetës në vitin 2008 arritën në rreth 515 milionë lekë, ose rreth 26% më të larta se në vitin 2007. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredihënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie. Produktet e tjera të mirëfillta të jetës mbeten ende të pazhvilluara në Shqipëri. AMF, në bashkëpunim me Bankën Botërore, organizoi në Prill 2008, një seminar të veçantë mbi sigurimet e jetës me pjesëmarrës nga të gjithë shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të produkteve të këtij tregu.

Shpërndarja gjeografike e sigurimeve

Duke i hedhur një vështrim primit të shkruar bruto sipas shpërndarjes gjeografike, vihet re një përqëndrim i tregut të sigurimeve në Prefekturat e mëdha.


Një tregues i rëndësishëm i këtij tregu është primi për frymë, i cili për vitin 2008 është rreth 2,227 lekë për frymë me një rritje prej 350 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas Prefekturave, prefektura e Tiranës me 4,797 lekë për frymë zë vendin e parë e pasuar nga prefektura Gjirokastër me 3,057 lekë për frymë dhe më tej Vlora dhe Durrësi përkatësisht me 2,179 lekë për frymë dhe 2,141 lekë për frymë.


Dëmet

Përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimeve është qëllimi kryesor i siguruesve në treg, që lidhet drejtpërdrejtë me pagesën e dëmeve. Gjatë vitit 2008, dëmet e paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve arritën në rreth 1.57 miliardë lekë, ose rreth 21% më shumë se në vitin 2007. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve të detyrueshme me 933 milionë lekë, apo 59% të totalit. Raporti i ulët dëme/prime tregon se tregu ka ende shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj klientit e publikut në tërësi.

Shpërndarja e primeve të sigurimit sipas prefekturave




Struktura e dëmeve të paguara 2008






Pagesat e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në vite (milionë lekë)



Dëmet e paguara sipas prefekturave



Risigurimet

Rreziqet e kontraktuara dhe mbulimi me risigurim

Gjate vitit 2008 shoqëritë e sigurimit kanë lidhur kontrata me vlerë mbi 30 milionë lekë,

të cilat i përkasin si sigurimit të pasurive të ndryshme, sigurimit të bankave, sigurimit të marinës e aviacionit, sigurimit të Jetës, ashtu edhe sigurimit të përgjegjësive siç është rasti në ndërtimit të rrugëve të ndryshme gjatë gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, apo sigurimit të përgjegjësive ndaj palëve të treta të drejtuesve të automjeteve si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në vendet e tjera anëtare të sistemit të Kartonit Jeshil.

Lidhur me këto kontrata të mëdha, Autoriteti ka monitoruar në mënyrë konstante mënyrën e administrimit të riskut prej shoqërive të sigurimit, të cilat kanë kryer diversifikimin e portofoleve të sigurimit, si nëpërmjet bashkësigurimit ashtu edhe kalimit si në risigurim të portofoleve të sigurimit në tërësi ashtu edhe mbulimin me risigurim fakultativ në kontrata të veçanta, në funksion të rritjes së kapacitetit të tyre dhe zbutjes së efekteve financiare prej dëmeve të mëdha.

Marrëveshjet risiguroese në portofolet e sigurimit të jo-jetës kanë qenë si të formës jo proporcionale të tipit Excess of Loss, ashtu edhe të formës proporcionale të tipit Quota Share.

Ndërkohë, në sigurimin e Jetës, mbulimi me risigurim është kryer nëpërmjet marrëveshjeve risiguroese të formës proporcionale të tipit Surplus e të tipit Quota Share.

AMF ka monitoruar marrëveshjet risiguroese dhe kontratat fakultative të risigurimit në përputhje me kërkesat ligjore të mbajtjes maksimale për rrezik dhe kritereve të lidhura me cilësinë e risiguroesve.

Më shumë se 80% e partnerëve risiguroes të shoqërive të sigurimit kanë klasifikim më të lartë se BBB në Standard & Poors, nga ku mbi 50% kanë klasifikim më të lartë se A. Ndër pjesëmarrësit kryesor në këto programe risigurimi mund të përmendim Munich Re, Hannover Re, Swiss Re, Scor, Lloyd's Syndicates, Revios, etj.

Krijimi dhe mbajtja e përshtatshme e provigjoneve teknike e matematike të sigurimit

Një pikë kyçe në mbarëvajtjen e aktivitetit siguroes të shoqërive të sigurimit është edhe përlllogaritja dhe mbulimi me aktive të përshtatshme të provigjoneve teknike e matematike të sigurimit. Provigjonet teknike të sigurimeve formohen për përmbushjen e detyrimeve të pritura, përgjegjësine për vazhdimësinë e mbulimit deri në përfundimin ose rinovimin e ardhshëm të polices së sigurimit, detyrimeve që lindin nga ngjarjet e sigurimit të ndodhura të cilat për një arsye a një tjetër qëndrojnë ende pezull. Provigjonet teknike duhet të jene në masë të tillë që të mbulojnë në mënyrë të qëndrueshme detyrimet dhe përgjegjësitë. Kështu këto provigjone janë monitoruar dhe analizuar në mënyrë periodike gjatë gjithë vitit 2008.




Komiteti i Aktuarëve

Në zbatim të Ligjit nr. 7641, datë 01.12.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike ndaj personave të tretë” dhe Rregullores nr. 622/1, datë 15.12.1992 (e ndryshuar) në datë 07. 05. 2002 “Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, Autoriteti shqyrtoi dhe miratoi propozimin e Komitetit të Aktuarëve lidhur me tarifat e sigurimit të detyrueshëm TPL e brendshme, të cilat më pas u miratuan edhe prej Ministrit të Financave nëpërmjet Urdhërit nr. 82, datë 19.06.2008 “Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Gjatë vitit 2008, tregu Shqiptar i sigurimeve të jo-jetës u nda ndërmjet shoqërive të sigurimeve: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me rreth 27.0% të primeve.

Gjatë vitit 2008, aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan shoqëritë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me rreth 40% të primeve.



II.2 Tregu i letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë, vazhdon të dominohet nga tregtimi në tregun primar dhe atë sekondar të instrumenteve të borxhit të Qeverisë (bono thesari dhe obligacione), ndërsa tregu i letrave me vlerë të aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar dhe i kufizuar kryesisht në tregun informal të aksioneve të kompanive të regjistruara pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve.

Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Gjatë vitit 2008, tregu u dominua krejtësisht nga transaksionet në instrumentet afatshkurtër (bonot e thesarit) dhe shënoi ulje të nivelit të transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, krahasuar me vitin paraardhës.

Tabelë 12: Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale (në mln lekë)		Ndryshimi (në %)
		2007	2008	'08 / '07-1
Letra me Vlerë të Qeverisë				
A	Blerje në tregun primar	9,183.37	7,199.20	(21.61)
	Individë	6,108.82	5,588.12	(8.52)
	Persona juridikë	3,074.54	1,611.08	(47.60)
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	8,634.71	8,457.89	(2.05)
	Individë	8,419.70	6,693.88	(20.50)
	Persona juridikë	215.01	1,764.00	720.43
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	522.78	617.90	18.20
	Individë	468.18	604.31	29.08
	Persona juridikë	54.60	13.59	(75.11)
D	Vendosje e bonove si kolateral	83.46	97.63	16.98
	Individë	49.02	84.03	71.42
	Persona juridikë	34.44	13.60	(60.51)
E	Shlyerje e vlerës nominale në maturim	5,554.98	6,167.63	11.03
	Individë	4,197.03	5,709.81	36.04
	Persona juridikë	1,357.95	457.82	(66.29)

GSRM (Tregu me pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë)

Gjatë vitit 2008, platforma GSRM, e ka përmbushur më së miri rolin e saj drejt rritjes së transparencës në lidhje me kuotimet dhe transaksionet në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë. Ecuria e sistemit ka qenë normale dhe operatorët e licencuar nën monitorimin e AMF janë kujdesur që informacioni të jetë i përditësuar në kohë sa më reale.

Tashmë platforma GSRM i jep një informacion më të plotë dhe të përditësuar publikut dhe investitorëve institucionale në lidhje me kërkesat dhe ofertat ditore në tregun me pakicë të instrumenteve të borxhit të Qeverisë. Gjithashtu, në këtë platformë, përfshihet dhe një bazë e të dhënave historike, e cila i vjen në ndihmë personave të cilëve u nevojiten të dhëna dhe për qëllime statistikore apo akademike.

Kjo platformë është një nga rubrikat më të vizituara të faqes zyrtare të AMF nga publiku, me 10.16% të të gjitha vizitave. AMF, synon të shtojë elementë të rinj në këtë rubrikë, të cilët do t'i japin mundësinë publikut të prodhojë statistika në kohë reale nëpërmjet faqes së internetit të AMF, në lidhje me transaksionet, kuotimet apo operatorët e këtij tregu.



Tregu i kapitaleve

Tregu i aksioneve vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar. Edhe viti 2008 nuk shënoi ndonjë ngjarje të re për zhvillimin e aktivitetit në Bursë. Listimi i shoqërive dhe tregëtimi i aksioneve në Bursë mbetet një përpjekje potenciale. Pavarësisht nga përpjekjet e vazhdueshme të Bursës së Tiranës për të afruar biznesin vendas, faktorë të shumtë si: madhësia e bizneseve (kryesisht si biznes i vogël dhe i mesëm), mënyra e funksionimit të biznesit, trashëgimia kulturore dhe mentaliteti, kriza financiare ndërkombëtare kanë ndikuar në moszhvillimin e tregut të kapitalit.

Nga ana tjetër, interesimi i subjekteve të huaja për zhvillimin e aktivitetit të Bursës, apo për zhvillimin e aktivitetit të ndërmjetësimit janë tregues optimistë për zhvillimin e tregut të kapitalit.

Zhvillimi i shpejtë i ekonomisë dhe i sektorit financiar, shtrojnë nevojën e intensifikimit të procesit të zhvillimit të tregut të kapitaleve. Privatizimi i paketave të aksioneve të shoqërive strategjike shtetërore në tregun e kapitaleve, si dhe ofrimi i iniciativave të ndryshme fiskale e ligjore për të nxitur biznesin vendas, janë rrugët nëpërmjet të cilave Qeveria mund të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të nxitjes së zhvillimit të këtij tregu.

Në mungesë të një tregu formal, aksionet vazhdojnë të tregtohen në mënyrë të paorganizuar, që konsiston në transaksionet e ekzekutuara kryesisht mes aksionarëve të shoqërive të privatizuara, pa përfshirë edhe transaksionet mes aksionarëve të shoqërive të tjera aksionare. Si rezultat i fenomenit të konsolidimit të pronësisë në shoqëritë e privatizuara, numri i transaksioneve në aksione për këto shoqëri ka ardhur duke u ulur nga viti në vit, ndërkohë veprime në lidhje me kapitalin aksionar dhe strukturën aksionare vazhdojnë të regjistrohen pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve (ORA).

ORA është shoqëri aksionare, që zotërohet në masën 85% nga shteti. Kjo shoqëri është licencuar nga AMF si regjistër i aksioneve. Përveç regjistrimit të pronësisë së kompanive në formë elektronike (Book-Entry), ORA ofron edhe shërbime të tjera për shoqëritë e regjistruara. Në fund të vitit 2008, ORA numëron 47 shoqëri aksionare të regjistruara, 12 prej të cilave janë institucione financiare (3 banka, 8 kompani sigurimesh dhe 1 regjistrar letrash me vlerë).

Gjatë vitit 2008, ORA ka reflektuar në regjistrat e aksioneve të shoqërive aksionare 494 transaksione, krahasuar me 262 transaksione të kryera në vitin 2007. Numri i aksioneve të tregtuara në tregun e paorganizuar gjatë vitit 2008, përbën rreth 8.77% të të gjithë aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë ORA-së, çka tregon se likuiditeti vazhdon të mbetet i ulët edhe në tregun e paorganizuar të aksioneve.

Tabelë 13: Statistika mbi transaksionet e regjistruara në QRA për vitin 2008

<i>Nr. Klasifikimi</i>	<i>Statistika</i>
1. Nr. Total i shoqërive aksionere të regjistruara pranë QRA-së	47
2. Nr. Total i aksioneve të shoqërive të regjistruara pranë QRA-së	15,563,277
3. Nr. Total i shoqërive, aksionet e të cilave janë tregtuar	19
4. Nr. Total i transaksioneve të ekzekutuara gjatë vitit 2008	494
5. Nr. Total i aksioneve të tregtuara gjatë vitit 2008	1,365,602
6. Përqindja e transaksioneve të tregtuara gjatë vitit 2008	8.77%

Burimi: Qendra e Regjistrimit të Aksioneve

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA)

Qendra e Regjistrimit të Aksioneve vepron me licencë që nga viti 2002, me objekt regjistrimin e aksioneve të shoqërive aksionare. Në mbeshtetje të nenit 6, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 "Per titujt", Titujt regjistrohen në qendrat e specializuara për mbajtjen e regjistrave të titujve, që organizohen në përputhje me ligjin, dhe licencohen nga Autoriteti, për të ushtruar veprimtari si regjistrarë të titujve.

QRA, krahas mbajtjes së regjistrit ofron edhe shërbime të tjera si:

- njoftimi i mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së aksionerëve
- llogaritjen e dividendëve
- konfirmimin e gjendjes së azhurnuar në çdo kohë të llogarisë së secilit aksionar

II.3 Tregu i pensioneve private suplementare

Zhvillimi i Instituteve të Pensioneve Private Suplementare


Tregu i pensioneve karakterizohet nga një shkallë e ulët zhvillimi, me vetëm tre institute private të pensioneve, që vazhduan të ushtrorjnë veprimtarinë e tyre në treg, përkatësisht IAPPSSH, Capital dhe Sigma IPP, me një numër total prej 3,861 kontribuesish dhe 53.1 milion lekë kontribute të akumuluar.

- Shoqëria "Sigma IPP" sh.a, ka filluar aktivitetin më 01.01.2006. Për periudhën janar-dhjetor 2008, shoqëria ka 678 kontribues me rreth 11.5 milion lekë kontribute.
- Shoqëria "IAPPSSH" sh.a (Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare Shqiptare), ka filluar aktivitetin më 01.01.2006. Për periudhën janar-dhjetor 2008, shoqëria ka 1,641 kontribues me rreth 33.3 milion lekë kontribute.
- Shoqëria Instituti Privat i Pensioneve "Capital sh.a", filloi aktivitetin më 01.03.2006. Për periudhën janar - dhjetor 2008, ky institut mblodhi 8.2 milion lekë kontribute, me rreth 1,542 kontribues.



Tabelë 14: Tregu i Pensioneve Private

Shoqëria	Kontribute (në lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2007	2008		2007	2008
<i>Periudha janar-dhjetor</i>			<i>'08/'07 -1</i>		
IAPPSSH	25,608,870	33,314,145	30.09	79.69	62.66
Capital	2,801,000	8,278,100	195.54	8.72	15.57
Sigma IPP	3,727,027	11,570,162	210.44	11.60	21.76
TOTAL	32,136,897	53,162,407	65.42	100.00	100.00



Kuadri ligjor aktual në fushën e pensioneve private paraqitet shumë i vjetëruar, konkretisht Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, nuk i përshtatet standardeve ndërkombëtare dhe nuk përmban lehtësira fiskale, që mund të nxisin zhvillimin e këtij tregu.

Me qëllim përmirësimin e bazës ligjore të kolonës së tretë të pensioneve, AMF me asistencën e Bankës Botërore, ka hartuar projektligjin “Mbi fondet e pensionit vullnetar”, projektligji i cili vendos standardet e nevojshme për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve vullnetare në përputhje me direktivat e EU dhe standardet e OECD, IOPS duke krijuar kështu një bazë ligjore të përshtatshme për krijimin dhe zhvillimin e kolonës së tretë. Zhvillimi i kolonës së tretë të pensioneve, ka qenë dhe vazhdon të mbetet prioritet i AMF, ku dhe i është caktuar hapësira e duhur në drejtim të asistencës komunitare që AMF përfiton në kuadrin e instrumentit TAIEX. Kështu, një mision ekspertësh u organizua në këtë drejtim, me fokus evidentimin e situatës aktuale të Sistemit Privat të Pensioneve në Shqipëri, perspektivat e zhvillimit të tregut në Shqipëri, anën rregullative në përputhje dhe me parimet e IOPS si dhe Mbikëqyrjen me Bazë Risku për fondet private të pensioneve. Në vijim të këtij misioni dhe në kuadrin e hartimit të projektligjit “Mbi

fondet e pensionit vullnetar”, AMF në bashkëpunim me TAIEX, organizoi një seminar, mbi mundësitë e zhvillimit të tregut të pensioneve private, mikëqyrjen e tyre dhe eksperiencën ndërkombëtare në këtë fushë, duke u bazuar në shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve të ndryshëm nga Komuniteti Evropian. Vëmendje e veçantë iu kushtua mundësive të zhvillimit të këtij sektori, mbikëqyrjes efektive, nxitjes së skemës si alternativë afatgjatë kursimi, lehtësirave fiskale, si dhe mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit.

Fokusi për të ardhmen

Në fokusin e punës së Autoritetit në të ardhmen do të jetë: i) përafrimi i legjislacionit të fushës me atë të Bashkimit Evropian, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ii) strukturimi i zhvillimit të tregjeve sipas standardeve, iii) mbrojtja e konsumatorit.

Qëndrueshmëria makroekonomike e Shqipërisë, progresi në regjimin rregullator dhe mbikëqyrës të sistemit financiar jo-bankar, potencialet e larta që ofron vendi, masat e marra në drejtim të parandalimit të efekteve të krizës financiare botërore, pritet të shoqërohen me një zhvillim të mëtejshëm të tregjeve financiare jo-bankare.

Pritet një rritje në tregun e pensioneve private vullnetare si pasojë e miratimit të ligjit të ri, i cili nxit pjesëmarrjen nëpërmjet një politike shumë të favorshme lehtësirash tatimore.

Gjithashtu, ligji mbi fondet kolektive të investimeve dhe ai i obligacioneve të shoqërive aksionere dhe të qeverisë vendore, pritet të shtyjë përpara zhvillimin e tregut të letrave me vlerë dhe të krijojë një hapësirë më të gjerë në drejtim të shtimit të mundësive të investimit të kursimeve të individeve dhe aseteve të subjekteve të interesuara.

Këto zhvillime pritet të kenë ndikim pozitiv në rritjen e interesit të investitorëve të huaj prestigjiozë për tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri. Interesi i investitorëve seriozë, tashmë i konkretizuar në sektorin e sigurimeve, po vijon të rritet edhe për sektorët e letrave me vlerë dhe pensioneve private.


Zbatimi i përvojave dhe praktikave më të mira, i cili i ka dhënë frytet e veta me hedhjen në treg të produkteve të reja të sigurimeve, kryesisht në fushën e jetës dhe shëndetit, do të shihet si një udhëzues në drejtim të hapave të mëtejshëm. Ndikime pozitive priten në elementë të tjerë si qeverisjen e shoqërisë, aplikimin e kriterit fit&proper dhe cilësinë e shërbimeve.

Rritja e efektivitetit dhe integritetit të tregjeve financiare jo-bankare do të shoqërohet me fushata edukuese dhe nxitëse për publikun, që do të synojnë rritjen e ndërgjegjësimit, interesit dhe për rrjedhojë të kërkesës për produkte financiare.

AMF do të vijojë të gjejë së bashku me tregjet, mundësi të reja të zhvillimit të shëndoshë të tyre. Planifikimi i drejtë, i kombinuar me një staf të kualifikuar, dhe bashkëpunimi në rritje me tregjet, mbeten mjete të fuqishme në funksion të realizimit të prioriteteve dhe objektivave të AMF-së.

SHTOJCA A

Struktura e AMF



SHTOJCA B

Kuadri ligjor/rregullativ në sektorin jo - bankar

Në Fushën e Sigurimeve

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Përshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr.9267, datë 29.07.2004.	Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime.	Objekti i këtij ligji është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.
Dekret nr.295, datë 15.09.1992 i ndryshuar me Ligjin nr.7461, datë 1.12.1992, me Ligjin nr. 8729, datë 18.01.2001.	Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësi ndaj personave të tretë.	Dekreti vendos detyrimin për sigurimin e detyrueshëm dhe përgjegjësitë ndaj palëve të treta në rastet e aksidenteve duke parashikuar procedura për përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe parashikon gjithashtu krijimin e Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe procedurat e funksionimit dhe aktivitetit të saj. Ky akt është përkohësisht në fuqi deri në botimin në Fletoren Zyrtare të Ligjit të ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit".
VKM nr. 5, datë 07.01.2009 propozuar me vendim Bordi nr.166, datë 23.12.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr. 96, datë 03.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimeve	Ndryshimet në VKM nr. 96 datë 03.08.2008, kanë për qëllim rritjen e kufirit të sipërm të lejueshëm për investimin e provigjoneve teknike e matematike në toka dhe ndërtime, i cili do të jetë në masën 30 përqind, nisur dhe nga mundësitë e kufizuara të investimit brenda vendit.
VKM nr.96, datë 03.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr.3, datë 18.06.2007.	Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike dhe investimet e tyre nga shoqëritë e sigurimit	Kjo VKM përcakton mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike si pjesën pjesën më të rëndësishme të përgjegjëse të një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar detyrimet e tyre që lidhen drejtpërdrejt me kontratat e sigurimit.
VKM nr.79, datë 28.01.2008 propozuar me vendim Bordi nr.4, datë 30.08.2007	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për licënsimin e ndërmjetësve në sigurime si dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licënsës	Kjo VKM përcakton e kriteret dhe procedurat për licënsimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe në kriteret për licënsimin e aktivitetit të agjentit në sigurime.
VKM nr.164, datë 28.01.2008, propozuar me vendim Bordi nr.3, datë 30.08.2007.	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për licënsimin e vlerësuesve të dëmeve në sigurime	Kjo VKM parashikon dispozita të përgjithshme ku krahas karakteristikeve të licënses përcaktohen kufizime lidhur me aktivitetet e tjera detyrore që mund të ushtrohen vlerësuesi të cilat sipas projektit duhet të jenë vetëm ato që ushtrohen në pajtim me natyrën e profesionit të tij.
VKM nr. 403, datë 09.06.2005	Për caktimin e komisioneve, për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve	Qëllimi i këtij vendimi është caktimi i komisioneve, për përballimin e shpenzimeve të shqyrtimit dhe korrespondencës për dhënie dhe rinovim licencash, autorizimesh dhe miratimesh nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve nga subjektet përkatëse.
VKM nr.268, datë 28.04.2005	Mbi përcaktimin e kufijve maksimale të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit	Përcaktohen kufijtë maksimalë të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike në shoqëritë e sigurimit.

VKM nr.192, datë 25.03.2005	Për kriteret dhe procedurat e licencimit të agjentëve në sigurime si dhe rregullat për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre.	Vendimi përcakton kriteret profesionale dhe të besueshmërisë së agjentëve në sigurime si dhe parashikon procedura për licencimin dhe rregulla për mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjentëve.
VKM nr.191, datë 25.03.2005	Për miratimin e metodikës mbi mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementët që e përbëjnë atë	Në vendim përcaktohet mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit si dhe elementët që e përbëjnë atë.
Udhëzimi nr. 15, datë 22.02.2008, propozuar me vendim Bordi nr15, datë 22.02.2008	Për përmbajtjen e raportit të auditit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti i auditimit mbi shoqëritë të sigurimit, hartuar nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar
Udhëzimi propozuar me vendim Bordi nr.6 datë 30.08.2008.	Mbi administrimin e mirë të dëmeve në sigurime	Ky udhëzues përcakton parimet e mbrojtjes së policëmbajtësve, përfituesve apo palëve të treta. Në të njëjtën kohë dhe për shoqëritë e sigurimit përbën një element kyc në konkurrencën mes ofruesve të sigurimit dhe përmitrimit të imazhit publik të vetë industrisë.
Udhëzimi nr.24, datë 15.11.2007.	Për administrimin e dëmeve të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta	Ky udhëzim trajton dëmet pasurore dhe jopasurore të mbuluara nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm, procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, vlerësimin e dëmit dhe mënyrat e afatit e likuidimit dhe kontabilizimit të dëmeve.
Rregullore miratuar me vendim nr.18 date 27.03.2008 të Bordit të AMF	Për organizimin e testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme të organizimit të testimit për vlerësuesit e dëmeve në sigurime.
Rregullore miratuar me vendim Bordi nr.2, datë 18.06.2007.	Për kriteret e risigurimit	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë kriteret mbi bazën e të cilave lidhen marrëveshje risigurimi nga shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Rregullore miratuar me vendim e Bordit nr.3, date 3.10.2007.	Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm	Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për identifikimin dhe raportimin e shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorik përmes një regjistri elektronik të instaluar në serverat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
Rregullore miratuar me vendim nr. 4 datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit	Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrese.
Rregullore miratuar me vendim nr.5, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi përmbajtjen e programit të risigurimit të shoqërive të sigurimit dhe afatet kohore të paraqitjes pranë AMF	Kjo rregullore ka për objekt të përcaktojë rregullat bazë për hartimin e programit të nevojave për risigurim për çdo vit financiar të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore miratuar me vendim nr.6, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për rregullat, mënyrat dhe kushtet e raportimit të shoqërive të sigurimit në AMF	Objekti i kësaj rregulloreje janë rregullat e vendosura nga AMF për mënyrën e raportimit të shoqërive të sigurimit.



Rregullore miratuar me vendimin nr.7, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF ndryshuar me vendimin e Bordit Nr.10, datë 17.12.2007.	Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit	Objekti i kësaj rregullore është të përcaktohen kriteret dhe procedurat për shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar, që do të emërohen nga shoqëritë e sigurimit pas aprovimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe përmbajtja e raporteve të kontrollit mbi shoqëritë e sigurimit nga shoqëritë e ekspertëve kontabël të autorizuar. Ndryshimet konsistojnë në periudhën që një shoqëri ekspertësh kontabël të jetë jo më e gjatë se katër vjet në vazhdim nga momenti i miratimit të saj.
Rregullore miratuar me vendimin nr.8, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve matematike	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra e llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve matematike nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr.9, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi bazat, metodat e llogaritjes si dhe mënyrat e mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra llogaritjes dhe mbajtjes së provigjoneve teknike të sigurimeve të jo-jetës nga shoqëritë e sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr.13, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për procedurat e pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari sigurimi ose risigurimi në Republikën e Shqipërisë	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të ushtruar veprimtari si shoqëri sigurimi ose risigurimi dhe degë e shoqërisë së sigurimit të huaj, procedurat e krijimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë nga shoqëria e huaj e sigurimit si dhe procedurat për licencimin e zgjerimit të veprimtarisë së sigurimit të shoqërisë së sigurimit.
Rregullore miratuar me vendimin nr.14, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për disa kriteret që duhet të plotësojnë personat e zgjedhur ose të emëruar në organet drejtuese të shoqërive të sigurimit ose risigurimit	Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave në lidhje me profesionalizmin dhe me reputacionin e personave që kryejnë administrimin, drejtimin dhe kontrollin e shoqërise se sigurimit si dhe kufizimet që duhet të zbatohen në emërimin dhe në shkarkimin e tyre.
Rregullore nr. 622/1, datë 15.12.1993	Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta	Kjo rregullore ka si qëllim të përcaktojë kushtet dhe rregullat e përgjithshme për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta. Kjo rregullore është përkohësisht në fuqi deri në botimin në Fletoren Zyrtare të Ligjit të ri "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit"
Udhëzim miratuar me vendimin nr.10, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për listën e dokumentave të logaridhënies së detyruar vjetore e periodike të shoqërive të sigurimit e risigurimit	Objekti i këtij udhëzimi është listimi i të gjithë dokumentacionit të detyruar për dhënie llogari, në mënyrë periodike dhe vjetore ndaj AMF, të shoqërive të sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr.11, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatore	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për publikimin e të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur njohjen nga publiku të gjëndjes financiare të shoqërive të sigurimit dhe për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë së sigurimit për pagimin e dëmshpërblimeve dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera dhe përcaktimi i rregullave për dhënie e informacionit konsumatorit përpara lidhjes së kontratës së sigurimit, ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit.
Udhëzim miratuar me vendimin nr.12, datë 08.02.2007 të Bordit të AMF	Për përcaktimin e kriterëve të shoqërive të risigurimit me të cilat shoqëritë e sigurimit që ushtrojnë veprimtari ne Republikën e Shqipërisëmund të lidhin marrëveshje risigurimi	Ky udhëzim ka si objekt rregullimin e veprimtarisë risiguroese të shoqërive të sigurimit, që mund të risigurojë pjesë të përgjegjësisë që ka kontraktuar me të siguruarit, me shoqëritë risiguroese vendase, degë të shoqërive risiguroese të huaja të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ose shoqëri risiguroese të huaja që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë udhëzim.

Në Fushën e Letrave me Vlerë

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Pëshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008	"Për Titujt"	Ky ligj përcakton llojet e titujve, rregullon mënyrën dhe kushtet për emëtimin e titujve, tregtimin dhe regjistrimin, identifikimin dhe kryerjen e transaksioneve me to, përcakton personat dhe individët e autorizuar për kryerjen e transaksioneve me titujt, kushtet për organizimin e tregtimit publik të titujve, mbrojtjen e investitorëve dhe të mbajtësve të drejtave mbi titujt, kushtet për dematerializimin e titujve, organizimin e funksionimit e regjistrave të titujve, shkëmbimin dhe rregullimin e tregut të titujve.
Rregullore miratuar me vendim nr. 120, datë 02.10.2008 të Bordit të AMF	Mbi licencimin dhe mbikëqyrjen e bursës së titujve	Qëllimi i kësaj rregulloreje është të parashikojë kushtet, kërkesat dhe procedurat për licencimin e shoqërisë që do të veprojnë si bursë titujsh dhe kushtet dhe kërkesat për rregullimin dhe mbikëqyrjen e një shoqërie që vepron si bursë titujsh.
Rregullore miratuar me vendim nr. 115, datë 11.09.2008	Mbi përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive dhe të librit të transaksioneve	Kjo rregullore përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të librit të porosive të cilat duhen të mbahen nga shoqëritë komisionere për sa u përket transaksioneve në lidhje me titujt referuar në Nenin 42 pikat 1, 2, dhe 3 të ligjit nr. 9876, datë 21.2.2008 "Për Titujt".
Rregullore nr. 165, datë 23.12.2008	Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/ Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve	Kjo rregullore përcakton dokumentacionin shoqëruar të kërkesës dhe kriteret për licencim për veprimtari të tregtimit të titujve dhe të këshillimit në investime, përmbajtjen dhe procedurën e trajtimit të kërkesës për licencim, procedurën e miratimit të statutit të një shoqërie që krijohet për të ushtruar veprimtari të tregtimit dhe këshillimit në tituj, si dhe ndryshimet në këto akte dhe dokumentacionin për dhënien e miratimit të anëtarëve të bordit drejtues dhe drejtuesit kryesor të shoqërisë së brokerimit e këshillimit në investime.

Në Fushën e Pensioneve

Referenca Ligjore/Rregullative	Emërtimi	Pëshkrimi i Ligjit/Rregullores
Ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 8393, datë 02.09.1998 dhe ligjin 9181, datë 05.02.2004	Për pensionet suplementare dhe Institutet private të pensioneve	Objekti i këtij ligji është të rregullojë sigurimin e pensioneve private nga institutet private të pensioneve, veprimtarinë për krijimin, licencimin dhe kontrollin e tyre.
VKM nr. 908, datë 29.12.2004	Për procedurat e licencimit dhe mbikëqyrjes së instituteve private të pensioneve	Vendimi përcakton dokumentacionin e nevojshëm për përfitimën e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat pensionesh, kushtet për dhënien e lejes dhe procedurën e miratimit të kësaj lejeje për mbikëqyrjen dhe kontrollin financiar.
Rregullore miratuar me vendim nr.16, datë 8.02.2007 të Bordit të AMF	Për procedurat e licencimit dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare	Objekti i kësaj rregulloreje është mënyra paraqitjes së dokumentacionit për licencim si dhe procedurën e ndjekur nga autoriteti për dhënien e lejes për ushtrim veprimtarie si institut privat i pensioneve suplementare".
Rregullore miratuar me vendim nr. 11 datë 22.02.2008 të Bordit të AMF	Për mbikëqyrjen dhe kontrollin e instituteve private të pensioneve suplementare	Kjo rregullore ka si qëllim mbikëqyrjen në institutet private të pensioneve suplementare, parandalimin dhe zbulimin e të metave, parregullsive, shkeljeve ligjore dhe marrjen e masave për korrigjimin e tyre.
Udhëzim, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 2, datë 21.11.2007.	"Për procedurat e inspektimit në subjektet financiarë jo-bankarë"	Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare.



SHTOJCA C

Lista e institucioneve të mbikëqyrura

TREGU I SIGURIMEVE

	1. INSIG sh.a	2. SIGMA sh.a	3. SIGAL UNIQA Group Austria sh.a	4. ATLANTIK sh.a
Drejtor Ekzekutiv	Saimir ZEMBLAKU	Qemal DISHA	Avni PONARI	Dritan ÇELAJ
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jete + Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete, Risigurime	Sigurime Jo-Jete.
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital shtetëror dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas.
Adresa e Selisë	Rr. "Dibrës" Nr. 91, Tiranë.	Rr. "Komuna e Parisit", Kutia Postare Nr. 1714, Tiranë.	Bul. "Zogu I", Nr.1 , Kutia Postare Nr.2387, Tiranë.	Rr. "Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë.
Tel./Faks	+355 42 234 169/ 170	+355 42 258 254, +355 42 258253	+355 42 250 220	+355 42 235 088
Faqja e Internetit	www.insig.com.al	www.sigma-al.com	www.sigal.com.al	www.atlantik.com.al
Posta Elektronike	info@insig.com.al	info@sigma-al.com	info@sigal.com.al	atlantik@atlantik.com.al info@atlantik.com.al
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 03 dhe 04, dt.08.06.2000.	Vendim Nr. 01, dt. 03.02.1999.	Vendim Nr. 06, dt. 03.02.2006	Vendim Nr. 5, dt. 13.04.2001.
	5. INTERSIG sh.a	6. ALBSIG sh.a	7. INTERALBANIAN sh.a	8. EUROSIG sh.a
Drejtor Ekzekutiv	Fitnete SULA	Gezim HUQJ	Bardhyl MINXHOZI	Muharrem BARDHOCI
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.	Sigurime Jo-Jete.
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital vendas.
Adresa e Selisë	Rr. e Durrësit, pranë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi", Godina Intersig, Tiranë.	Rr. "Punëtorët e Rilindjes", Nr.10, Tiranë.	Rr. "Sulejman Delvina", Zayed Business Center, Kutia Postare Nr.2771, Tiranë.	Rr "Lek Dukagjini", Nr. 5, Tiranë.
Tel./Faks	+355 42 235 614, + 355 42 232 462	+355 42 254 761/762/764/770	+355 42 229 511, +355 42 229 578	+355 42 238 899, +355 42 223 841
Faqja e Internetit		www.albsig.com.al	www.interalbanian.com	www.eurosig.al
Posta Elektronike	intersig@albaniaonline.net	info@albsig.com.al	ttroqe@interalbanian.com	info@eurosig.al
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 6, dt. 13.09.2001.	Vendim 10, dt. 19.07.2004.	Vendim Nr. 9, dt. 19.07.2004.	Vendim Nr. 7, dt. 8.07.2004.
	9. SICRED sh.a	10. SIGAL-LIFE, UNIQA Group Austria, sh.a	11. MAI sh.a.	
Drejtor Ekzekutiv	Genc KOXHAJ	Edvin HOXHAJ	Plarent HAMZAJ	
Fusha e Aktivitetit	Sigurime Jete.	Sigurime Jete.	Broker në sigurime dhe risigurime	
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital vendas.	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj.	Shoqëri me kapital të huaj.	
Adresa e Selisë	Rr. "Sami Frashëri", Pall. 20/10, Tiranë.	Bul. "Zogu I", Nr 1, Tiranë.	Rruga "Vaso Pasha", Pallati 8, Ap. 7/B, Tiranë	
Tel./Faks	+355 42 237 549	+355 42 233 308		
Faqja e Internetit	www.sicred.com.al	www.sigal.com.al		
Posta Elektronike	contact@sicred.com.al	infolife@sigal.com.al		
Data e Fillimit të Aktivitetit	Vendim Nr. 8, dt. 26.07.2004	Vendim Nr. 11, date 28.07.2004.	11.09.2008	

TREGU I LETRAVE ME VLERË

1. BURSA E TIRANËS sh.a		2. Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve sh.a		3. RAIFFEISEN BANK sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Anila FURERAJ	Enton SHAHAJ	Oliver J. Whittle		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Treg i organizuar letrash me vlerë	Regjistruer i aksioneve të shoqërive akcionare	Tregtar dhe Regjistruer i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital shtetëror	Shoqëri kryesisht me kapital shtetëror.	Shoqëri me kapital të huaj		
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Dora D'Istria", Nr.2, Kútia Postare 274/1, Tiranë	Rr. "George W. Bush", Nr.13, Tiranë.	European Trade Center, Bul. "Bajram Curri", Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 265 058	+355 42 233 442, +355 42 233 425	+355 42 274 910		
<i>Faqja e Internetit</i>	www.tse.com.al		www.raiffeisen.al		
<i>Posta Elektronike</i>	tseinfo@abcom-al.com	qra@abissnet.com	info@raiffeisen.al		
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>		05.11.2002	28.09.2005		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat		
4. BANKA KOMBËTARE TREGTARE sh.a		5. INTESA SANPAOLO Bank Albania sh.a		6. ALPHA BANK - Tirana sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Seyhan PENCAPLIGIL	Lucrenco RONCARI	Andreas GALATOULAS		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar dhe Regjistruer i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH	Tregtar dhe Regjistruer i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH	Tregtar dhe Regjistruer i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital të huaj		
<i>Adresa e Selisë</i>	Bul. "Zhan D'ark", Tiranë	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 27, Tiranë	Bul. "Zogu I", Nr. 47/1, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 250 955, +355 42 250 956	+355 42 248 753/4/5/6/7, +355 42 220 160	+355 4 240 478, +355 4 232 102		
<i>Faqja e Internetit</i>	www.bkt.com.al	www.ambankalb.com			
<i>Posta Elektronike</i>	info@bkt.com.al	americanbank@ambankalb.com			
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	21.12.2005	24.11.2005	13.02.2006		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat		
7. BANKA CREDINS sh.a		8. BANKA E TIRANËS sh.a		9. BANKA POPULLORE sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Artan SANTO	Bedri ÇOLLAKU	Henry Maus de ROLLEY		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar dhe Regjistruer i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital vendas dhe të huaj	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri me kapital privat të huaj dhe vendas		
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Ismail Qemali", Nr. 21, Tiranë	Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë	Rr. "Donika Kastrioti", Nr. 11/1, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 234 096, +355 4 258 752	+355 42 269 616, +355 42 269 707	+355 42 272790/1, +355 42 272781		
<i>Faqja e Internetit</i>	www.bankacredins.com	www.tiranabank.al	www.bpopullore.com		
<i>Posta Elektronike</i>	info@bankacredins.com	info@tiranabank.net	info@bpopullore.com		
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	08.05.2006	05.11.2002	23.03.2005		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat	Pa afat	Pa afat		



10. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE		11. KAPITAL INVEST sh.a		12. TRIUMF GROUP sh.a	
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Mahendra Singh RAWAT	Lirim MUHARREMI	Mirela ANGJELI		
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar në letrat me vlerë të Qeverisë së R.SH në Bursë	Tregtar i Letrave me Vlerë në Bursë dhe në Tregun me Pakicë	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë		
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital të huaj.	Shoqëri me kapital të huaj dhe vendas	Shoqëri me kapital privat vendas		
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Murat Toptani", Kati VII, pranë "Gjergji Center", Tiranë, Shqipëri	Bul. "Dëshmorët e Kombit", Twin Towers Nr. 2, Kati i 11, Tiranë	Rr. "M. Gjollësja", Kulla 2, ap. 13, Tiranë		
<i>Tel./Faks</i>	+355 42 254 372, +355 42 254 368	+355 42 280 202	+355 68 20 58 275 / +355 42 256 081		
<i>Faqja e Internetit</i>					
<i>Posta Elektromike</i>					
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	27.03.2008	05.04.2007	24.11.2003		
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>		Pa afat	Pa afat		
10. BALLKAN GROUP-01 sh.a					
<i>Drejtor Ekzekutiv</i>	Genci RAMAJ				
<i>Fusha e Aktivitetit</i>	Tregtar në letra me vlerë të Qeverisë në Bursë				
<i>Lloji i Pronësisë</i>	Shoqëri me kapital privat vendas				
<i>Adresa e Selisë</i>	Rr. "Reshit Çollaku", Pall. 7-katësh tek Shalvaret, shk.2/6. Tiranë				
<i>Tel./Faks</i>	+355 4 233 537, +355 4 233 537				
<i>Faqja e Internetit</i>					
<i>Posta Elektromike</i>					
<i>Dt. e Fillim. të Licenc.</i>	24.11.2003				
<i>Dt. e Mbarim. të Licenc.</i>	Pa afat				

FONDET E PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE

1. Instituti Amerikan i Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë		2. SIGMA IPP	3. CAPITAL Instituti Privat i Pensioneve
Drejtor Ekzekutiv	Arjan KRAJA	Hait LLESHI	Naim HASA
Fusha e Aktivitetit	Institut Privat Pensionesh Suplementare	Institut Privat Pensionesh Suplementare	Institut Privat Pensionesh Suplementare
Lloji i Pronësisë	Shoqëri me kapital të huaj	Shoqëri me kapital privat vendas dhe të huaj	Shoqëri me kapital privat vendas.
Adresa e Selisë	Rr. "Mustafa Matohiti", P. 11 katësh, kati 2, zyra 1, Tiranë.	Rr "Komuna e Parisit, Kutia Postare Nr. 1714, Tiranë	Rr. "Urani Pano", Pallati i ri, Kati II, Tiranë
Tel./Faks	+ 355 42 240 207/8	+355 42 258 254, + 355 42 258 253	+ 355 42 250 220
Faqja e Internetit	www.apfa.com.al		www.capital.com.al
Posta Elektronike	info@apfa.com.al		contact@capital.com.al
Data e Fillimit të Aktivitetit	01.01.2006	01.01.2006	01.03.2006



SHTOJCA D

Anëtarësime dhe marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara

A. Marrëveshje të Nënshkruara me Organizata Brenda Vendit	Viti	Institucioni
- Fakulteti i Ekonomisë	2002	KLV (sot AMF)
- Instituti i Ekspertëve Kontabël (IEKA)	2003	KLV (sot AMF)
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor	2003	AMS (sot AMF)
- Autoriteti Bankar dhe Paguesave i Kosovës	2004	AMS (sot AMF)
- Banka e Shqipërisë	2005	AMS, KLV (sot AMF)
- Autoriteti i Konkurrencës	2006	AMF
B. Marrëveshje të Nënshkruara me Institucione Homologe Jashtë Vendit		
- Komisioni i Tregut të Kapitaleve të Greqisë	1999	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë të Quebec-ut	2000	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Italisë	2002	KLV (sot AMF)
- Agjencia e Tregut të Kapitaleve të Sllovenisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Polonisë	2003	KLV (sot AMF)
- Bordi i Tregut të Kapitaleve i Turqisë	2003	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar i Bullgarisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni Kombëtar i Letrave me Vlerë i Rumanisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Maqedonisë	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Bursave i Malit të Zi	2005	KLV (sot AMF)
- Komisioni i Letrave me Vlerë i Kroacisë	2005	KLV (sot AMF)
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)	2008	AMF
C. Anëtarësime në Organizma Ndërkombëtare të Rregullatorëve		
- IOSCO (Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë)	1998	KLV (sot AMF)
- IAIS (Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve)	2001	AMS (sot AMF)
- IOPS (Organizata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Pensioneve)	2006	AMF

SHTOJCA E

Tabelat statistikore



Treguesit Kryesore Makro-Ekonomikë 1998-2008

Treguesit e Përgjithshëm

Treguesit	Njësia											
	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	
Popullsia	000	3,061	3,049	3,058.5	3,063	3,084	3,103	3,120	3,135	3,149	3,162	3,168
Te punësuar gjithsej	000	1,085	1,065	1,068	921	920	926	931	932	935	966	970
Te papunë të regjistruar	000	235	240	215	181	173	164	157	154	150	143	141
Papunësia	%	17.7	18.4	16.8	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.2	12.7
Produkti i Brendshëm	mln Lekë	409,209	471,578	523,043	583,369	622,711	694,098	750,785	814,797	891,000	982,737	1,090,305
	mln USD	2,716	3,425	3,640	4,066	4,443	5,696	7,305	8,159	9,082	10,859	12,997
	mln Euro	3,209	3,209	3,918	4,561	4,721	5,037	5,875	6,555	7,244	7,932	8,879
Rritja reale e PBB-së	%	9.0	13.5	6.7	7.9	4.2	5.8	5.7	5.8	5.5	6.3	7.2
PBB për frymë	mijë Lekë	133.7	154.7	171.0	190.4	201.9	223.7	240.7	259.9	282.9	310.8	344.2
	USD	887.3	1,123.2	1,190.0	1,327.2	1,440.6	1,835.7	2,342.0	2,602.6	2,884.0	3,437.0	4,102.5
	Euro	-	-	1,281.0	1,489.1	1,531.3	1,622.8	1,883.7	2,090.3	2,299.8	2,509.0	2,803.4
Inflacioni												
Mesatar vjetor	%	21.6	0.4	0.1	3.1	5.2	2.4	2.9	2.4	2.4	2.9	3.4
Fund i periudhës	%	8.7	(1.0)	4.2	3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1	2.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Treguesit e Financave Publike

Treguesit	Njësia matjes	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Totali i të Ardhurave	mIn Leke	102,524	123,161	130,643	145,639	154,595	167,224	184,356	204,163	226,283	251,600	290,078
	rritja (%)	73.9	20.1	6.1	11.5	6.1	8.2	10.2	10.7	12.4	9.6	15.3
	% e PBB	25.1	26.1	25.0	25.0	24.8	24.1	24.6	25.1	25.8	25.6	26.6
Të Ardhurat Tatimore	mIn Leke	72,576.1	83,565.9	104,112.3	114,293.9	128,948.4	145,388.1	165,974.8	183,816.0	205,523.0	228,163.7	264,080.2
	rritja (%)	59.2	15.1	24.6	9.8	12.8	12.7	14.2	10.7	11.8	11.0	15.7
	% e PBB	17.7	17.7	19.9	19.6	20.7	20.9	22.1	22.6	23.1	23.2	24.2
Totali i Shpenzimeve	mIn leke	141,628.4	165,691.9	170,621.1	186,049.3	192,516.9	201,152.3	222,438.6	232,338.8	258,815.5	285,015.9	350,266.6
	rritja (%)	40.6	17.0	3.0	9.0	3.5	4.5	10.6	4.5	11.4	10.1	22.9
	% e PBB	34.6	35.1	32.6	31.9	30.9	29.0	29.6	28.5	29.0	29.0	32.1
Investimet Publike	mIn Lekë	24,215.3	35,567.2	37,658.3	45,097.3	40,754.2	34,619.0	42,555.4	45,416.0	59,890.0	63,551.6	101,824.6
	% e PBB	5.9	7.5	7.2	7.7	6.5	5.0	5.7	5.6	6.7	6.5	9.3
Deficiti i Përgjithshëm	mIn Lekë	(39,104.9)	(42,530.2)	(39,978.9)	(40,409.9)	(37,921.6)	(33,928.3)	(38,083.2)	(28,176.3)	(29,371.7)	(33,460.6)	(60,188.5)
	% e PBB	(9.6)	(9.0)	(7.6)	(6.9)	(6.1)	(4.9)	(5.1)	(3.5)	(3.3)	(3.4)	(5.5)
Borxhi i Brendshëm	mIn Lekë	149,439.0	177,490.0	226,069.0	241,161.0	260,752.0	280,767.0	295,200.0	327,353.0	348,935.0	369,536.0	384,548.1
	% e PBB	36.5	37.6	43.2	41.3	41.9	40.5	39.3	40.2	39.2	37.6	35.3
Borxhi i Jashtëm	mIn Lekë	64,515.5	74,431.7	90,127.8	95,613.8	132,219.1	130,471.9	131,216.9	140,398.0	145,021.6	146,925.7	181,624.7
	% e PBB	15.8	15.8	17.2	16.4	21.2	18.8	17.5	17.2	16.3	15.0	16.7

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave

Treguesit e Tregtisë së Jashtme

Treguesit	Njësia matjes										
	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Bilanci Tregtar											
mln USD	(646.3)	(561.5)	(802.9)	(937.7)	(1,160.0)	(1,419.0)	(1,637.4)	(2,013.5)	(2,119.8)	(2,862.5)	(3,556.3)
% e PBB	(23.8)	(16.4)	(22.1)	(23.1)	(26.1)	(24.9)	(22.4)	(24.7)	(23.3)	(26.4)	(27.4)
Eksporti											
mln USD	208.0	275.1	255.4	304.6	330.3	447.2	603.7	660.1	790.8	1,077.1	1,340.3
% e PBB	7.7	8.0	7.0	7.5	7.4	7.9	8.3	8.1	8.7	9.9	10.3
Importi											
mln USD	(811.7)	(937.9)	(1,076.4)	(1,331.6)	(1,485.4)	(1,783.5)	(2,191.0)	(2,498.8)	(2,871.2)	(3,959.4)	(4,875.0)
% e PBB	(29.9)	(27.4)	(29.6)	(32.8)	(33.4)	(31.3)	(30.0)	(30.6)	(31.6)	(36.4)	(37.5)
Bilanci i Llogarisë Korrente											
mln USD	(65.1)	(132.8)	(172.0)	(282.3)	(422.0)	(399.7)	(422.8)	(733.4)	(591.4)	(1,139.2)	(1,888.7)
% e PBB	(2.4)	(3.9)	(4.7)	(6.9)	(9.5)	(7.0)	(5.8)	(9.0)	(6.5)	(10.5)	(14.5)
Investimet e Huaaja Direkte											
mln USD	45.0	41.2	143.0	207.3	133.0	177.5	332.4	260.6	313.9	643.8	906.1
% e PBB	1.7	1.2	3.9	5.1	3.0	3.1	4.6	3.2	3.5	5.9	7.0
Transferrat											
mln USD	503.9	353.4	526.8	516.2	628.6	870.0	1,043.2	1,116.7	1,268.0	1,428.6	1,214.8
Rezervat Valutore											
mln USD	256.5	346.8	491.8	627.2	703.7	904.6	1,239.5	1,325.5	1,700.0	2,033.9	2,367.2
Kursi i kembimit											
Lek/USD	150.6	137.7	143.7	143.5	140.2	121.9	102.8	99.9	98.1	90.5	83.9
Lek/Euro	147.0	147.0	133.5	127.9	131.9	137.8	127.8	124.3	123.0	123.9	122.8

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave




Agregatët Monetarë

Treguesit	Njësia matjes		1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Agregati M1	mln Lekë		83,729	103,004	124,041	142,926	145,902	141,987	170,075	223,657	242,391	242,676	282,862
	në %		-8.7	23	20.4	15.2	2	2.6	19.7	31.5	8.3	0.1	16.6
Agregati M2	mln Lekë		199,264	239,662	264,497	305,302	321,622	351,291	393,282	426,499	477,373	506,138	555,005
	në %		22.8	20.3	10.4	15.4	5.3	9.2	11.9	8.4	11.9	6	9.7
Agregati M3	mln Lekë		239,526	292,871	328,101	394,316	408,129	443,527	503,256	573,049	666,467	757,610	815,705
	në %		20.6	22.3	12	20.1	3.5	8.6	13.4	13.8	16.3	13.6	7.7


Burimi: Banka e Shqipërisë




Produkti i Brendshëm Bruto (miliardë lekë)
Rritja reale (në%)




Produkti i Brendshëm Bruto (miliardë Euro)
Rritja reale (në%)




Inflacioni (në%)



Investimet (në %)




Borxhi Publik në %




BTH 3 Mujore viti 2008

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2008			
Janar	5.08	6.20	3.00
Shkurt	4.80	6.26	3.60
mars	4.84	6.25	4.60
Prill	5.06	6.29	4.40
Maj	4.96	6.28	4.20
Qershor	5.00	6.27	4.00
Korrik	5.21	6.28	3.70
Gusht	6.27	6.26	2.50
Shtator	5.08	6.24	2.70
Tetor	5.02	6.23	2.80
Nëntor	5.09	6.05	2.60
Dhjetor	5.23	6.27	2.20



BTH 6 Mujore viti 2008

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2008			
Janar	5.65	7.30	3.00
Shkurt	5.44	7.29	3.60
mars	5.42	7.36	4.60
Prill	5.64	7.47	4.40
Maj	5.61	7.48	4.20
Qershor	5.76	7.46	4.00
Korrik	5.99	7.46	3.70
Gusht	6.09	7.39	2.50
Shtator	5.81	7.33	2.70
Tetor	5.76	7.2	2.80
Nëntor	5.95	7.42	2.60
Dhjetor	5.76	7.45	2.20



BTH 12 Mujore viti 2008

Muajt	Interesi i Depozitave	Yieldi i BTH	Norma e Inflacionit
Viti 2008			
Janar	6.49	8.14	3.00
Shkurt	6.10	8.00	3.60
mars	6.11	8.02	4.60
Prill	6.41	8.12	4.40
Maj	6.72	8.16	4.20
Qershor	6.55	8.19	4.00
Korrik	7.72	8.21	3.70
Gusht	7.71	8.15	2.50
Shtator	7.25	8.02	2.70
Tetor	6.90	7.94	2.80
Nëntor	6.82	8.1	2.60
Dhjetor	6.86	8.56	2.20

